BUZUKU

ISSN 1800-9476

SHOQATA DON GJON BUZUKU ULQIN

numër 38

Revistë informative, kulturore e shoqërore
Ulqin, e diele më 23 dhjetor 2012



fq. 7




fq. 16



fq. 10



fq. 5



Pjetër Përkoliqi - përkujtim



Pjetër Perkoliqi (14.08.1922-7.09.2006)

Më 7 shtatuor 2006 diq imzot Pjetër Perkoliqi, biskupi (ipeshkvi) i Tivarit n'penzion. Më 9 shtatuor, të dijellen, u rimuo n'kishën e biskupad's (ipeshkvisë) n'Tivar (Bar); n'ora dhetë* u tha mesha. Zotni Pjetri mállin e ti n'Bartull ja ká lânë djalit vllajit. Kyj njeri i vijejshëm erdhi pej Rromet si meshtar i ri më 1946. Menjëherë e thirren n'komitet t'partisë, i premtuon me kijen profesor n'gimnozin e Tivarit, me rrogë t'mirë e me banesë, vetëm mos me kijen meshtar. Dom Pjetri nuk pranon. Kur panë se me t'mirë nuk bâhet gjâ, e çojnë n'burg n'Bogdanoj Kraj n'Cetinjë, burgu mâ i keq n'atë kohë. E shpalljen shpijun i Vatikanit. Përdoruon dhunë, munime qi t'ja kthejnë menimin, por aj qinroj si burrat, mas do kohet e lshuon, por menjerë e moren n'ushtri. Masi e kreu ushtrinë, biskupi e caktoj meshtarë n'Shestan, ven pa rruga, pa strujë. Edhe aty e penguon n'punën e ti, por aj prapë se prapë qinroj si burrat.

Më 1979 dom Pjetri u emnuo arqipeshkëv i Tivarit. Atë vjetë, dridhja e tokës rrenoj kisha e shpija.

Me dekjen e zotit Pjetër, kisha, Shestani dhe katoliktë tretën nji prisë t'urtë e t'pa harrueshëm. Aj kurrë s'e mohoj Shestanin, komin e vet, gjuhën shqype, adetet e Shestanit. Nanën e vet edhe n'Cetinjë e pat t'vishun shestaneshë.

*Shestanasit në vend të ***dh*** thonë ***ll***. Katundet shestanase janë pjesë e Kranjës veri-perëndimore (jug-perëndimi i Liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit, Mali i Zi).

Shkruan **Gjergji Leks Macit Kols Perkolonj** (Perkoliq; 26.08.1926-), shestanas, Te-Pleva, Fusha e Tivarit, më 13.10.2012.

Mos ban keq se deri i shtati brez e paguon

Kjo fjalë e urtë ká kijen e provuome, kanë thánë t'moçmit. Për me mujtë m'e treguo vërtetimin e sajë, duhet shpjegimi. Pra, po'j biem shkurt për nji nodhje*.

Më 1918, malazezët e Crmicës dogjën në Shestan shum shpija, u vodhën gjânat qi viejnë; prenë desh e baca (dele), shtinë duart nëpër kaca. Shestanasit tue u tremë, më 1941 shkojnë n'Shqypni, e pej Taljanve kërkojnë armë me ruojtë votrat e veta. Taljant napen 300 pushkë e municion dhe Shestanin e shpallin ZONË NEUTRALE. Për kryetar ZONET populli zgjedh Lekën e Macit Kols Perkolonj pej katunit Nrekonj (Karanikiq). Masi n'BUZUK kena shkrua gjatë për ato nodhje dhe për Lekën, ktu po shkruonj gjânat qi lidhen me thân'jen nalt.

Më 1945, Lekën, Gjonin e Zefit dhe Vukën e Pjetrit i burgosjen. Më 1946, kta tre n'Cetinjë i gjykojnë për dek, si anmiq populli. N'gjykim ka kijen vllaji jem Zefi, kurse unë isha n'Bosne. Kur dolën jasht para gjygjit, vjen nji gruo e i thotë Zefit: Po t'kërkon gjygjtari. Zefi, pak i trishtuon, shkon te aj. Gjygjtari çohet n'kamë, i nep dorën Zefit. I kalxon karrigën m'u ulë dhe i thotë: *Unë e kam lexuo gjykimin për tatën tuoj, por atë gjykim e ka pru partija. Tata juoj asht i pa faj. Aj jo se ka pshtuo Shestanin, por edhe Crmicën. Pra, Shestanasit e Crmiçant kishte lypë Lekës me i bâ spomenikun (përmendoren) n'Vir. Unë e shoh si detyrë ta pshtonj ket burr t'pa faj.*

Daktillorafit i përsëriti meritat e Lekës. Atë letër ja nep Zefit e i thotë: *Let nënshkruhen nja 50 burra, ma bjerë muo, se unë do ta nisinj për Beograd.* Zefit i nënshkruhen 280 vetë. Nji ditë para se me shkuo për Cetinjë, komunistat e Peconjve (Draçevica), me n'krye Vasin e Pjetrit Zoges, e bajnë me ditë komitetin n'Tivar. Vinë te Zefi dy milicë e i thonë se duhet me shkuo me ta n'komitet n'Tivar. N'komitet ishte nji Mitroviq. I thotë Zefit: *Ti ke bâ do shkrime, mi nep t'i shoh.* Zefi ja nep. Aj i shikoj, i shkjeu dhe i hodhi n'kosh. At'herë me idhnim i thotë Zefit: *Ti ke guxim me bâ ksi gjânash për anmikun e popullit.* Zefi i thotë qi atë letër ja ka bâ gati gjykatësi n'Cetinjë.

Partija me'njerë organizon komunistat e Pecojve, u nep nji letër tjetër e u thotë: *Shkoni derë për derë, tremne popullin qi t'nënshkruhën, demek po shtojmë nënshkrimet e parë.* Kta komunista, luftar n'zâ t'nënjarganit, kijen Vasi, Nikolla'j Stjeps, Gojkja Gjurs Pers, Andrija'j Macit, si dhe Pala'j Pjetrit Nik'Çobs, nji shpijun pej Nrekonjsh. Palën e nisnin n'Bujgër, Nikollën n'Nrekonj e Gjuraç, e Vasin n'Peconj. Ata i mledhin njâ 30 nënshkrime n'krye t'letërs ven: *Dole potpisani traže smrtnu kaznu za Leku Perkoliq.*

N'shtatuor më 1956, Lekën, Vukën e Gjonin i pushkatojnë n'gudurat e Lovqenit, jo vetëm se u morën jetën por me tretë edhe eshtrat. Zoti vonon por nuk harron, më 12 tetuor më 2002, eshtnat e prinve tonë i prumë n'Shestan.

Si shkrova mâ nalt, Lekën e gjykuon Vasi e Nikolla, Gojkoja e Andrija dhe shpijuni Pala'j Pjetrit. Kjo kije shpërblimi për Lekën, i cilli i pshtoj Pecanjort jo vetëm 'njerë. Ktu duo me bâ fjalë për nji nodhje t'vërtetë n'Peconj. N'prenverë 1943, nji komandant çetnksh me 15 djelmoça t'armatosun me mashinka, për me mujtë me hyp n'Shestan, e merr nji oficer Taljan me veti. Ishin nisë me djegë katunin Peconj, se thanjin se aty ka partizana e komunista. Shestanasit me'njerë e bânë me ditë Lekën. Aj merr vllain Preçin, Palën e Preçit qi flitte mirë taljançen, Pjetrin e Niks e Gjok Lulën, e u dalen çetnikve përmi Peconj, te nji djerr me do ubla. Sa ja mrrinë Gojniqi, i thotë Lekës: *Na kena ardh me djegë Draçevicën (Peconjt), se aty ko komunista e partizana.* Me'njerë j'arritën Bujgras, Gjuraçash, bile edhe do djelmoça pej Muriqit. Kta zunë ven nëpër do megja t'gatshem për çdo nevojë. Taljani si dhe çetnikt u shqetsuon. Taljani e bveten Lekën: *Kush janë kta*? Leka i përgjigjet: *Kta janë djelmoçat e mi, e armtë naj kanë dhânë Taljant. Më 1918 t'partë e ktyne çetnikve na kanë djegë shum shpija e na kanë plaçkitë. Na kena kërkuo kto armë me mujtë me pruo venin tonë. Pej nesh nuk asht vra asnji Taljan; Taljant jav vranë kojshija'j ktyne. Unë garantonj se n'Draçevicë nuk ko as partizana e as komunista.*

I pari komunist kije Vasi Pjetrit Zoges n'kallnuot 1944. Leka i sillet Gojniqit: *Ti komunistat e partizant i ke te shpija. Shko e lufto atje.* Çetniktë u detyruon t'shkojnë kah kanë ardhë pa e damtuo Shestanin.

Tash po kthehem n'fjalën e urtë *Mos ban keq se do ta paguash*. Leka i pshtoj ata, por ata e gjykuon Lekën. Me gjykimin e Lekës u gjykuon edhe vetë ata.

I pari, Vasit i diq djali 19 vjeç, i vdes edhe shoqja dhe vajza, e Vasin si inforbirovac e majnë n'burg n'Goli Otok 4 vjet e gjysë. *I dyti*, Nikolla des n'rrugë 60 vjeç, nji djalë qi kishte i biret n'vapore. *I treti*, Andrija pat nji djalë, i des 3 vjeç. *I katërti*, shpijuni Pala, i del shpirti n'qenef në Titograd (Podgoricë). *I pesti*, Gojkoja ko shkuo n'Beograd, kurr mâ s'jena tokuo. Ata qi Zefit i morën letrën, dy kushërinj Mitroviqa moren fun n'Goli Otok. Nuk m'vjen mirë qi gabimin e prinve e paguon ata t'po fajit.

*Shestanasit në vend të ***dh*** thonë ***ll***. Katundet shestanase janë pjesë e Kranjës veri-perëndimore (jug-perëndimi i Liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit, Mali i Zi).

Shkruan **Gjergji Leks Macit Kols Perkolonj** (Perkoliq; 26.08.1926-), shestanas, Të-Pleva, Fusha e Tivarit, më 13.10.2012.

PËRMBAJTJA

2. Pjetër Perkoliqi - përkujtim
Mos ban keq se deri i shtati brez e paguon
3. Kanga e Ulkrinit (Ulqinit)
4. Premiera e koreodramës “Kalendari” në Ulqin
5. Shqiptarja që e nderon krejt bota
6. Manifestimi “Ora e Maleve“ në Rozhajë
7. Rrëfimi i shestaneshës, krenare për rranxën e vet
8-9. Aktivitetet e Shoqatës Buzuku më 2012
10-11. Ma të parat kopje të fotografueme të Mesharit të Buzukut ndë Shqipëni
12. Dalja masive biblike në maje të Rumisë
13. Teksti i memorandumit të Shestanasve
14-15. Što su Šestani izgubili u procesu slaviziranja
16. Shqiptarët në veprat e Andreja Kaçiq-Mioshiqit
17. Një diasporë shembullore në Itali
18. Bisedë me Mrikën, bashkëshorten e Gjergj Nrekiqit
19. Në hap me Rugovën
20. Botime të reja
21. Popullore
22. Poezi
23. Të ndryshme

Buzuku 38

REVISTË E PËRKOHSHME INFORMATIVE, KULTURORE E SHOQËRORE
Boton:
Shoqata për kulturë " Dom Gjon Buzuku"
Këshilli programor:
Gjergj Pepgjoni, Mr. Rrok Gjolaj, prim.dr.Gani Karamanaga, prof.dr. Mentor Disha, prof.dr.Hysni Hoxha, prof.dr.Jahja Drançolli, Vera Kovaçi, Lekë Brisku, Mitër Pekaj, Gjystina Dabaj, Gjergj Perkolaj, Zef Kovaçi, Mark Junku, Gjurë Dabaj, Lubo Lukiqi
Kryeredaktor:
Simë Gjon Dobreci
Zavendës i kryeredaktorit
Gjergj Anton Filipaj
Ndihmës të kryeredaktorit
Gjekë Gjonaj
Bahri Brisku
Redaksia:
Mr. Riza Rexha, prof.dr. Ruzhdi Ushaku, Prof. Dr. Hajrullah Koliqi, Idriz Ulaj, Loro Markiqi, Ali Gjeçbritaj, Pjetër Ivezaj, dr.Lukë Gjokaj, Kolë Camaj, Zef Lukiqi, Drane Marvuçiqi, Gjokë Dabaj
Fotoshërbimi:
Foto Studio Ars, Foto Rozafa, Foto Arb, Art Foto Prishtinë, Foto Bruno
Realizimi artistik:
Fisnik Dobreci & Gazmend Çitaku
Adresa e redaksisë:
Bul. Gjergj Kastrioti Skënderbeu
85360 ULQIN
Nr.tel. ++382 (0) 30 401-384, 069 441-943
www.buzuku.info
E-mail: fdobreci@t-com.me;
Loromark@t-com.me
Numri i llogarisë rrjedhëse
Banka komerciale malazeze A.D.
Ekspozitura Ulqin Nr. 510-0-40
Thirrje ne Nr. 510270393491001825
Revista është rregjistruar në Sekretariatin Republikan për Informata të Malit të Zi, nr. 04 / 01- 466
Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen

Kanga e Ulkrinit (Ulqinit)*

Shqyptaria asht n'rezik. Shqeht po rhethojn venin ton. ... Kena per prove lirin qi u ka dhan Bulgharve me hymun n'Dibre; ene n't'tjera vene kena per prove Potgoricen ene Ulkrinin qi i ka damun ka Shqypnia per me i dhan Malit-Zi. A u ka dal mensh moti kur Ulkrini i therun, i coptue, vikaste e nokonte? Atbot, kinoni ktu kangen e Ulkrinit, t'ciln e ka bomun populhi ene t'ciln e kena nighumun do vjet ma par n'Dibre:

Lam t'mir, o ditt e para!
Se kinojn gazetat e Stamolls:
Hot e Grudes ka dal fjala,
Ja ka fal mreti Nikolhs,
Hot e Gruda jan mleth,
Rin ne Shkodre me qa breng,
Pa ghak malet mos me i leshu!
Jena nis me u-ba me vet,
Hot e Gruda jan betu,
Per me ñoft ñi t'par,
Hodo pashen kan shinu,
Nuk a pun pa mos arth
Hodo pasha paske than:
Un jam nodh ne ushtri
I huth format e miralhjajis,
Per me dhan ner Shqypnis.
Haghi pashen e kam çue,
Pri mretit me kalhxue,
Thujmni Shkodres e Malcis,
Ulkrinin t'ma falin mua.
Malcija i dha liri,
Po thot Shkodra s'po nighojm,
Te shtat Rigatat me mleth ushtri,
Ulkrinin pa pushk s'e lishojm,
Dervish pasha na mrini!
Na mloth ghin per ñi here,
Nuk a pun pa u-dhan Ulkrini,
Kam Stamolhin rhethuar,
E kam mretin ne zendan,
Do me hy Shqahu n' Stamolh
Pogoret t'u-gatit,
Ushtri e Turkut t'u-afrit,



Faik Konica
(15.03.1875 në Konicë – 15.12.1942 në Uashington)

Zoti driten ja u past dhan,
Tet te vra kan met Shkodran;
U-nis Shqahu pri Potgorice
Me s'di sa tabore,
Krisi pushk e voghlis
Dulen jasht disa dragua,
U-nis prap pri Potgorice
Sa me shpejt i u-prish ushtris,
E ka marun vesht Evropa,
Ushtar trim nxjerka Shqypnia.
(*Gegnisht, nga populhi*)

*** Kanga e Ulqinit.**
(“*Albania*” /e Faik Konicës/ viti II, nr. 9, 31 kalenduar, Bruksel, 1898, fq. 148 – '49).
(E përgatiti: Hajro ULQINAKU)

---

569 vjetori

Gennaio - Aprile 2012 LAJME/NOTIZIE 73

ODA E MIQVE

1912 ~ 2012

GËZUAR
100° vjetorin e parë të
Pavarësisë së Popullit Shqiptar

28 Nëntor 1912

«Shqipëria sot bahet më vehte, e lirë dhe e mosvarme»

Ismail Qemal Vlora i shoqënuem nga patriot e përfaqësues të shquem të Kombit, mbasi nuk mujti të shpalli pavarësinë kombëtare, për shkaqe të ndryshme rrethanash në Shkodër, Krujë, Durrës, Elbasan, si ishte deshira e tij, u nis për në Vlorë, ku nga ballkoni i shtëpisë stërgjyshore, më 28 Nandor 1912 ngriti flamurin kombëtar - si Skënderbeu, në Krujë, më 28 Nandor 1443, ngriti flamurin e Derës së Kastriotve me shqiponjën e zezë dykrenore me fushë të kuqe që u bë flamuri historik i luftërave për liri i Populli Shqiptar- dhe shpalli pavarësinë kombëtare tue themelue, kështu, Shtetin e parë Shqiptar.

Në këtë urim për 100 vjetorin e Pavarësisë së Popullit Shqiptar përmendet Nandori i parë 1443 dhe Nandori i dytë 1912.

Marrë prej revistës arbëreshe: **Lajme/Notizie**, XXIV, nr.1, 2012: 73; 87010 Lungro (CS), Italia

Po nuk lidhem krenín e emnit shqiptar me besë, nderë, burrní, mikpritje, d.m.th. me trashëgim stërgjyshnuer, sa për vetina tjera, cilat do qofshin, na radhitemi në bisht të kombeve t'Evropës

(Ernest Koliqi).

* * *

Arma më e fortë e një populli të pushtuar është durimi

(Konrad Adenauer).

Buzuku 38/2012

Premiera e koreodramës “Kalendari” në Ulqin


Foto ARB

Shkruan **Ismet Kallaba**

Në Ulqin u shënua 100-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë me aktivitete të shumta, në organizim të Këshillit Nacional të Shqiptarëve në Malin e Zi

100 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë është kremtuar me aktivitete të shumta në Ulqin, të organizuara nga Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Mal të Zi. Për nder të 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit dhe 100-vjetorit të Pavarësisë, në Qendrën e Kulturës në Ulqin të shtunën, më 24.11.2012, është shfaqur premiera e koreodramës “Kalendari”, e cila flet për jetën dhe dramën e shqiptarëve në Mal të Zi gjatë shekullit të kaluar. Kjo koreodramë, e ndarë në tri pjesë, flet për tri kohë të ndryshme që i kanë përjetuar shqiptarët gjatë 100 vjetëve. E para është periudha kur shqiptarët kanë qenë të bashkuar, e dyta ilustron vuajtjen e ndarjes së shqiptarëve me kufij, ndërsa pjesa e tretë flet për ribashkimin e shqiptarëve. Kalendari” i jetës së shqiptarëve në Mal të Zi gjatë këtyre 100 vjetëve na shfaqet nëpërmjet dikotomive: optimizëm – pesimizëm, bashkim – ndarje, lumturi – vuajtje, gëzim – trishtim etj. Nëpërmjet valleve tradicionale dhe moderne, si dhe recitimit ilustrohet ankthi i shqiptarëve dhe dëshira e tyre për hapjen e kufirit me Shqipërinë dhe bashkimin e familjeve të ndara.


Foto ARB

Regjinë e koreodramës e ka realizuar Munib Abazi, udhëheqës artistik është Basri Milla, teksti është shkruar nga Valbona Hoxha, koreografia është realizuar nga Musa Hoxha, muzika Ardian Hasanaga dhe skenografia është punuar nga Agron Ujkashi. Në koreodramë marrin pjesë valltarët e Shkollës së Vallëzimit “Porta di Danza” dhe SHKA “Zana”, kurse rolet interpretohen nga Atif Hasanaga, Flutur Mustafa, Jenuz Abazi dhe Anida Kollari. Pas Ulqinit, koreodrama “Kalendari” është shfaqur të hënën në Teatrin Kombëtar të Kosovës në Prishtinë, kurse të martën në Teatrin Kombëtar në Tiranë.

Në kuadër të aktiviteteve të KNSH-së kushtuar Ditës së Flamurit dhe 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, në galerinë e arteve të Qendrës së Kulturës në Ulqin është hapur ekspozita e piktorëve vendas. Studentët e Ulqinit në Prishtinë kanë shfaqur po ashtu të dielën, më 25.11.2012, në Qendrën e Kulturës programin e titulluar “100 minuta për 100 vjetor”. Një program tjetër, i përbërë me muzikë, këngë, valle, recitime etj. është shfaqur të martën, më 27.11.2012, po në Qendrën e Kulturës në Ulqin.


Foto ARB


Foto ARB

Shtatorja e Nënës Tereze në Montreal, *Kanada*

Shqiptarja që e nderon krejt bota

Për nder të 100-vjetorit të pavarësisë të Shqipërisë, më 24 nëntor 2012, në Montreal, *Kanada, u përurua* **shtatorja e Nënës Tereze, ku** *folën* kryetari i bashkësisë së Jug-Perëndimit të Montrealit Benoit Dorais, deputetja e parlamentit federal kanadez znj. Hélène LeBlanc, krye-peshkopi i Montre-alit Christian Lépine, *ambasa-dorja e Shqipërisë në Kanada znj. Elida Petoshati*, kryetari Bashkësisë Shqiptare të Kebekut në Montreal, z. Kujtim Ismaili, Përveç nga Montreali, shqiptarët erdhen në ceremoni edhe nga Ottawa, si dhe prej Torontos me përfaqësuesin e misionit shqiptar "E lumja Nënë Tereza", Gjergj Nikolla. Në ceremoni ishin të pranishme mediat vendase, frankofone dhe anglofone, si dhe përfaqësuesi i televizionit shqiptar **PASQYRA** në Toronto z. Ilir Lena



Njofton **Ajet Nuro**, Montreal, e-mail: anuro@albemigrant.com, më 25-26 nëntor 2012.

Nxjerrë nga **gazeta Tribuna Shqiptare**.

Benoit Dorais dhe **Kujtim Ismaili** duke zbuluar shtatoren e Nënës Tereze. *Skulptori* **Benard Lekgegaj**



Marrë nga fjala përshëndetëse e Tahir Tahirit*

Ulqini qytet i lashtësisë, krenarisë dhe pavarësisë së Shqipërisë. Simbol i dashurisë, paqes dhe lirisë. Ulqini, një çështje e trajtuar shumë pak nga historia shqiptare, sikurse edhe Hasan Prishtina por roli dhe fama e tyre ishte e përmasave evropiane. Shndërrimi i krizës Lindore në një krizë globale ndalohej me dorëzimin e Ulqinit nga diplomacitë e fuqive të mëdha. Më krizën e Ulqinit të gjitha kancelaritë evropiane do flasin për çështjen Shqiptare dhe Shqipërinë. Me Ulqinin fillon edhe rruga drejtë pavarësisë së Shqipërisë. Strategu i madh dhe shtetndërtuesi i Shqipërisë Ymer Prizreni, vorri i të cilit ndodhet në Ulqin, është një dëshmi dhe krenari për të gjithë kombin shqiptar. Prandaj Ulqini ashtu sikurse gjithë trevat shqiptare në Malin e Zi me dinjitet feston Jubileun e madh te shtetit shqiptarë


Foto ARB

Festa e Flamurit dhe 100 vjetori i shtetit shqiptarë është një ngjarje madhore për mbarë kombin shqiptarë. Është ngjarje madhore edhe për ne Shqiptarët në Malin e Zi, të cilët përgjatë këtyre 100 viteve kanë kaluar edhe sot kalojnë nëpër shumë sfida, sakrifica, në mbrojtje të gjuhës, kulturës e historisë.

Për fat të keq, shqiptarët në Malin e Zi sot, si popull autokton në trojet e veta, vazhdojnë gjithnjë përpjekjet e tyre për të drejtat kombëtare. Përkundër shpresës, pozita e tyre nuk është përmirësuar pas pavarësimit të Malit të Zi. Për më tepër, kohës së fundit atyre u janë hequr (marrë) disa të drejta të arritura. Shqiptaret në Malin e Zi sot nuk kane të drejtë të përdorimit të lirë në institucionet publike të simbolit kombëtarë me rastin e kremtimit të festave kombëtare, siç është kjo sot. Mirëpo, nje pjese te përgjegjësisë për këtë e kanë edhe vetë shqiptarët, faktori politik shqiptar, i cili vazhdon të jetë i përçarë. Prandaj, le të jetë ky përvjetor edhe një moment reflektimi për ne, për bashkimin e shqiptarëve në Mal të Zi, sepse vetëm të bashkuar do të bëjmë realitet idealin për të cilin luftuan e sakrifikuan një plejadë e tërë e martirëve e patriotëve të shquar, të cilët dhanë edhe jetën për një gjuhë, një komb e një ideal. Në këtë kontekst, ashtu si deri më tani, Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Malin e Zi do të përpiqet dhe do vazhdojë të jetë promotor dhe faktor i bashkimit të shqiptarëve.

Pavarësisht se të ndarë fizikisht, sot JEMI NJË. Të gjitha qytetet dhe vendet ku jetojnë shqiptarët sot janë veshur dhe stolisur kuq e zi. Sot festohet njëjtë, në Vlorë, Tiranë, Prishtinë, Shkup, Preshevë, këtu në Ulqin, Malësi, Plavë, Rozhajë, Anë të Malit, Tivar, Krajë. Kjo dëshmon se shqiptarët kudo që jetojnë, janë të bashkuar shpirtërisht.

Unë Ju bëj thirrje edhe një herë të gjithë atyre që nuk e kanë bërë deri tani, që të ba-shkohen me nismën dhe të ngrehinë flamu-rin në shtëpitë e tyre, si simbol i bashkimit të shqiptarëve. Këtë ju kemi borxh atyre që luftuan për flamurin dhe për pavarësinë.

***Tahir Tahiri,** drejtor i KNSH në Malin e Zi; *Marrë nga* Fjala përshëndetëse në manifestimin në Ulqin më 24.11. 2012, me rastin e kremtimit të 28 nëntorit – Ditës së Flamurit dhe 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë.

Buzuku 38/2012

Manifestimi “Ora e Maleve“ në Rozhajë

Shkruan Ali Daci

Në Rozhajë për te katërtën here u mbjat ***Manifestimint Tradicional letrar “Ora e Maleve“ me 28.4.2012 në Qendrën për Kulrurë në Rozhajë; u promovuan i tre vëllime të veprave historike të prof. Jusuf Buxhovi si dhe u hap ekspozita personale e piktorit kosovar Idriz Berisha, ndërsa mbi tridhjetë krijues letrarë nga gjitha trojet shqiptare kanë proklamuar vargjet e tyre krijuese në prozë apo poezi.***

Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Mal të Zi për tretën herë më radhë ka organizuar Manifestimin Tradicional Letrar “Ora e Maleve” ku kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i personaliteve të artit, shkencës, e fjalës së shkruar, nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia si dhe krijues nga të gjitha trevat shqiptare në Malin e Zi, Ulqini, Ana e Malit, Kraja, Malësia, Plava e



Rozhaja. Fillimisht në galerinë e arteve në Qendrën për Kulturë është hapë ekspozita e piktorit akademik Idriz Berisha nga Klina, hapjen e së cilës e bëri piktori rozhajas Aldemar Ibrahimoviq, me ç'rast i vlerësoi lartë pikturat e Berishës, për të cilat foli edhe analisti Prend Buzhala nga Klina. Piktori Berisha u falënderua edhe për mikpritjen gjatë ekzodit kosovar, si dhe i dhuroi deputetit Mehmet Bardhit një pikturë. Duke hapur manifestimin kryetari i Këshillit Naciona të Shqiptarëve në Malin e Zi z. Tahir Tahiri mbasi përshëndeti të pranishmit dhe krijuesit, si dhe pjesëtarët e familjeve e të rënëve nga plumbat e terrorit serb në Malësinë e Rozhajës në vitin 1999. Mandej ai tha se manifestimi i sivjemë është më i veçantë, se po promovojmë veprën kombëtare “Kosova I.II.II” të profesor Jusuf Buxhovit dhe ky manifestim mbahet në vitin jubilarë të 100 vjetorit



të pavarësisë së Shqipërisë. Këshilli Nacional i Shqiptarëve ka si qëllim mbrojtjen, afirmimin, avansimin dhe realizimin e të drejtave kombëtare, kulturore, gjuhësore dhe i të gjitha të drejtave të tjera me interes për shqiptarët. Ky manifestim shënohet për çdo vit, në shenjë nderimi dhe përkujtimi të martirëve të Kosovës të vrarë në Malësinë e Rozhajës me 28 Prill 1999 nga forcat policore-ushtarake e paramilitare serbe, në mesin e të cilëve kishte edhe gra e pleq. Për herë të parë “Ora e Maleve” u mbajt para 4 viteve nën organizimin e LD në MZ. Në fund, Tahiri përshendeti Akademik Rexhep Ferrin, prof. Jusuf Buxhovin, publicistin e poetin Smajl Smaka, prof. Isa Nikçi, shkrimtarin Petrit Palushi, Dr Agim Vinca,piktorin e poetin Idriz Berisha, prof. Ramiz Kelmendi, shkrimtarin Qerim Ujkani, prof. Abdullah Thaçi, dramaturgun e shkrimtarin Fadil Kraja, prof. Simë Dobreci, Mr. Ismail Doda,prof. Pjetër Dreshaj, Dr. Bahri Brisku, shkrimtarin Ibrahim Kadriu,Visar Zhiti e Adem Shkreli si dhe të gjithë krijuesit të tjerë që marrin pjesë në këtë orë letrare.

Recenzenti i veprave të “KOSOVA I,II,III” prof. Ramadan Musliu dha një vlersim të shkurtër rreth veprave të prof. Jusuf Buxhovit me çrast vlersoj se Historia e Kosovës e Jusuf Buxhovit, që po promovojmë sot e që doli nga shtypi, në tri vellime prej me shume se 2.300 , e përbëre nga tri pjesë: **“Kosova-Antika, Mesjeta”** , **“Kosova – Perandoria osmane”** dhe **“Nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar”**, paraqet një botim kapital brenda llojit të vet në studimet historiografike shqiptare. Autori i veprave historiografike “KOSOVA I.II.II” profesor Jusuf Buxhova tha se ndihet shumë krenar që sot ndodhet në mesin e bashkëvendasve të tij dhe falënderoi KNSH-në dhe organizatoret e Ores së Maleve për promovimin dhe mikpritjen që iu afrua.

Mbas promovimit të librit, nga një poezi nga krijimtaria e tyre letrare i lexuan shkrimtarët Ramiz Kelmendi, Medina Xhuraj, Fadil Kraja,Adem Shkreli, Qerim Ujkani, Rexhep Ferri, Ibrahim Kadriu, Jonuz Fetahaj, Agim Vinca, Visar Zhiti, Mexhid Mehmeti, Smajl Smaka, Nezir Sefaj, Petrit Palushi, Abdulla Thaçi etj.

Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Mal të Zi dhe Këshilli Organizativ i Manifestimit Tradicional Letrarë “Ora e Maleve” këtë vit, për herë të dytë, ndau 16 mirënjohje doenëve të artit, letërsisë, historisë dhe kulturës shqiptare, në shenjë nderi dhe respekti për punën dhe kontributin e dhënë në kultivimin e artit dhe gjuhës e letërsisë shqipe ndër shqiptarët e Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë, Shqipërisë, Luginës së Preshevës e Sanxhakut dhe më gjerë. Manifestimi financiarisht e përkrahi Fondi për Pakica. *Rozhajë, 28 prill 2012*



Më rastin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë

Rrëfimi i shestaneshes, krenare për rranxën e vet

Shkruen **Gabriella Simoni***

Unë jam antare e folklorit “Shestani“ t'Shoqatës “Don Gjon Buzuku” ktu n'Ulqin. Ky folklor u krijue para 2 vjetve, dhe sukseset çdo ditë e ma shum janë t'pranishme n'aktivtetin tonë. Qe n'fillim ishte nji msim, përvojë e madhe për t'gjithë ne dhe në t'njëjten kohë dhe nji sfidë, ngacmim qi s'na linte rahat, sepse vallja gati e harrueme fillojë ringjalljen e sajë, tue na ringjallë vetëdijen, dinjitetin dhe identitetit tonë.

Msuam hapat e parë t'valles shestanase si dhe kangët e vjetra t'cilat u kënduan para shum vjetve dhe u përcollën brez mbas brezit. Veshja shestanase është e veçantë, shum ngjyrshe dhe është një ndër veshjet ma t'vjetra shqiptare. Kjo veshje na banë t'ndihemi krenarë për rranxën tonë, prejardhjen tonë.



Presidenti i Shqipërisë, Bujar Nishani, Gabriella Simoni dhe Viktori i Gjergjit Toms-Lukiq më 25.11.2012

Kohë mbas kohe kemi shkue në prova dhe dalëngadalë e kemi mësue vallen, kështu mrritëm me marrë pjesë n'shum manifestime, tue i shtue festimeve edhe një folklor të llojit të veçantë, i cili ka mungue te na.

Mbas daljes së parë para publikut, ku me sukses e prezantuam veshjen dhe vallen e Shestanit që i ka munguue syrit dhe veshit të popullit tonë, erdhën kërkesat që t'marrim pjesë në manifestime të ndryshme, si n'Mal të Zi, po ashtu n'Shqipëri e ma gjanë.

Kemi marrë pjesë n'shum manifestime, si dhe n'festivale folklorike, për shembull, n'Sarandë, ku morëm çmimin e dytë dhe n'Lushnje çmimin e tretë. Këto dy çmime ishin nji gzim i veçantë për ne, që na motivoi të punojmë me zell dhe në t'ardhmen. E ky zell çdo ditë po rritet te brezat e ri t'bijve dhe bijave t'Shestanit.

Morëm pjesë edhe n'manifestimin “Ditet e shën Ndout në Braticë” (Ulqin), ku mbas shumë dekadave jehoj kënga dhe vallja shqype, pastaj n'manifestimin për festën e Pashkëve n'Grudë t'Malsisë.

N'manifestimin e 100 vjetorit t'ngritjese se flamurit të Dedë Gjo Lulit n'Deçiq t'Malësisë, që i ka parapri ngritjes se flamurit n'Vlorë. Morem pjesë edhe n'manifestimin e që u organizue n'Shkodër në vitin 2011, ku ishte i pranishëm edhe presidenti Bamir Topi. Ndër ata që pritshin kreun e shtetit, patëm nderin që ne, bijat dhe bijtë e Shestanit, të jemi në rendin e parë.

Me rastin e kremtimit t'100 vjetorit t'pavarsisë së Shqipnisë dhe 101 vjetorin e ngritjes se falmurit n'Deçiq, n'Shkodër morëm pjesë n'aktivitetet e organizueme për ketë rast në teatrin Migjeni t'cilin përveç personaliteteve t'njoftuna politike dhe kulturore prej t'gjitha trevave shqiptare, ishte i pranishem edhe Presidenti i Shqipërisë Bujar Nishani, i cili Malsinë e Madhe e shpalli Nderi i Kombit. N'ketë festim përfaqësuesit e shoqnise tonë patën nderin t'i dhurojnë një buqetë me lule presidentit Bujar Nishani, i cili e vlersoi lartë paraqitjen e grupit folklorik t'shestanasve.

Salla e teatrit Migjeni t'Shkodrës ishte plot e përplot me pjesëmarrës t'cilët e përcollën vallen tonë me duartrokitje dhe me emocione t'veçanta. Pastaj grupi ynë u ftua nga organizatorët e manifestimit t'100 vjetorit pamvarsisë për me marrë pjesë n'manifestimin qendrorë t'organizuem n'Tiranë.

Në Tiranë kaluem momente t'paharrushme, ishte nji kënaqësi dhe ndjesi e veçantë pjesëmarrja në manifestim madhështor gjithëkombëtar shqiptar, ku morën pjesë mbi 50 grupe të folklorit dhe individë prej t'gjitha trevave shqiptare, si dhe nga diaspora. Dhe, si mbas mediave, pati mbi nji milion njerëz që gzoheshin sebashku me ne.

Në momentin kur u pre torta gjigante ma e madhja n'botë dhe kur u shfaq parada ushtarake, organizatorët e çuen grupin tonë afër kryesisë së shtetit shqiptar me në krye Sali Berishën, Bujar Nishanin dhe Jozefinën Topallin, çka ishte nji nderim i veçantë për grupin tonë folklorik, si dhe nji knaqsi e madhe për shoqatën tonë Don Gjon Buzuku.

E gjithë Tirana ishte veshur me ngjyrë kuq e zi, çka hijeshonte krejt manifestimin, i cili na kaploi edhe ne, kështu që grupi ynë ato ditë u çmall me bashkëkombasit e tonë të trevave shqiptare, me shpresë se bashkëpunimi nuk ka me mungue.

Na i jemi falenderues secilit bamirës, secilit person, secilit njeri vullnetmirë që nuk i dridhet dora me na ndihmue që adetet, vallen të paraardhesve tonë, mos ta harrojmë, por t'ia lamë brezave t'ri. Jemi dhe kena me kjenë krenar me identitetin tonë shestanas.

I jam mirënjohes Zotit që me lindi n'një familje shestanase, i falenderoj prinderit e mijë që me rriten n'frymen e stergjysherve tonë shqyptarë. Tue besue se secila familje e ndjenë veten të tillë; secili i ri duhet të bashkohet në aktivitetet tjera për një jetë të gzueshme dhe ma t'mirë.

*Gabriella, e bija e Anrisë Gjonit Pjetër Gjonit-Simoni (Simononj), Braticë, tash n'Ulqin

Fishta do't thonte edhe sot:
Çou Mikel, kape lahutën,
E na kno nji kângë shqiptare,
Se na s 'jena tā zânë men,
Pa na shue shue fare.

Aktivitetet e Shoqatës BUZUKU më 2012

LUSHNJE 2012

Në kuadrin e 100 vjetorit të shpalljes së pavarësisë, Qendra kombëtare e veprimtarive folklorike organizoj Festivalin Folklorik Tipologjik Ndërkombëtar të valles burimore në qytetin e Lushnjes, prej 28 - 30 maj 2012. Festivalin e drejtoi Esat Ruka, drejtor i Qendrës kombëtare për veprimtarinë Folklorike. Grupi BUZUKU e fitoi ftesën dhe mori pjesë me këngën folklorike – potpuri këngësh popullore, Vallja e Shestanit. Grupi u akomodua në hotelin PiloLala dhe u prit posaçëm nga kryetari i bashkisë së Lushnjes. Për veprimtarinë kulturore dhe vlerësimin e prezantimit në festival, grupi jonë mori vendin e tretë në edicionin e 6 të festivaleve folklorike.


31.05.2012
Lushnje - dhuratë Shoqatës


Lushnje - qendra e qytetit 31.05.2012


Lushnje mirënjohje Shoqatës 31.05.2012


31.05.2012
Lushnje - diploma Shoqatës

SHKODRA 2012

Me 25 nëntorë 2012, Shoqata kulturore Koha Jonë, në teatrin **Migjeni** në Shkodër, organizon mbrëmje festive , edicionin e tretë me emrin KU E MUER EMNIN MALËSIA E MADHE, nën kujdesin e veçantë të Presidentit të Republikes, shkelqesisë tij Z. Bujar Nishani.

Udhëheqësi artistik, zotëri Rrok Gjelaj e ftoi edhe Shoqatën Buzuku, e cila u prezantua me vallen e Shestanit. Organizatorët posaçërisht e nderuan grupin tonë me detyrën fisnike që një tufë lulesh t'i dhurojmë Presidentit për mirëseardhje. Po ashtu edhe publiku me prezantimin tonë qe posaçërisht i kënaqur, sepse grupi jonë mori pjesë edhe në Edicionin e dytë i cili u mbajt në vitin e kaluar po ashtu në Shkodër.


Tiranë, Zef Lukiqi, Gjergj Pepgjoni dhe Zef Kovaçi më 18.11.2012




25.11.2012
Shkodër - grupi i vallëtarëve

Tuz, Grudë, 24.04.2011, me rastin e 100 vjetorit të ngritjes së flamurit në Deçiq



Para Bibliotekës Qendrore, Tiranë Zef Kovaçi, Gjergj Pepgjoni, Kristina Pepgjoni dhe Zef Lukiqi më 18.11.2012





Tirana 28.11.2012

Me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë grupi folklorik BUZUKU mori pjesë me këngën e Shestanit në manifestimin qendror që u mbajt në sheshin Skënderbeu në **Tiranë**.



28.11.2012

Në Tiranë



Tiranë - festimi *28.11.2012*



25.11.2012

Në Shkodër



Tuz, Grudë, 24.04.2011,
me rastin e 100 vjetorit të ngritjes së flamurit në Deçiq

Ulqin 2012 Grupin tonë e përcolli ARS Foto nga Ulqini.

*



UNIONI ARTISTIK I KOMBIT SHQIPTAR

I jepet Çmimi i Dytë

Ansamblit "Gjon Buzuku" Ulqin

Për një interpretim me mjeshtëri të rrallë në Festivalin e Pestë të Këngës dhe Valles së Çamërisë.

Drejtori i Përgj. Artistik
Minella Kureta
Mjeshtër i Madh

Sarandë, 27 Qershor 2011

Presidenti
Azgan Haklaj

Sarandë - diploma



31.05.2012

Lezhë - në Muze të Skënderbeu



Sarandë - Vallja shestanase, më 3.10.2011

Grupin tonë e thirrën për manifestim edhe në Strugë 2012, Prishtinë, Krajë 2012 dhe për manifestimin qendror në Vlorë më 28 nëntor 2012. Grupi në këto manifestimit nuk mori pjesë për arsye të mungesës financiare dhe të kohës.

Përgatiten **Gjergj Pepgjoni** *dhe* **Zef Lukiqi**

Buzuku 38/2012

Ma të parat kopje të fotografueme të Mesharit të Buzukut ndë Shqipëni

Shkruan **Justin RROTA**

Ende i ri me moshë, sado i ligshtuem kahë shëndeti, unë, aso pranvere 1929, jipshem gjithënjë mësim gjuhet ndër klasët e nalta të gjimnazit.
Lajmi i shpallun atëherë prej fletoresh e revistash mbrenda e jashta Shqipëniet, se gjindej ndër arkivat e Romës një kopje e librit ma të vjetrit shqip (1555), qyshë ndë fillim më kishte trandë e elektrizue.


Gjergj Fishta dhe Justin Rrota

Më dukej si çudë, nuk e kuptojshem dhe griheshem vetë me vete kahë mendojshem, si mund te rrijshin indiferentë sidomos masat intelektuale ndë një Shqipni, Shtet ndë vete, ndaj visarit buzukjan!
Kahë s'më linte e keqja e atij monumenti jetik, vorrue nd'errësin' e libravet të hueja larg atdheut, nd'atë pakicën teme, gjithësa munda dhe gjithësa dijta, nxita e mërzita të madh e të vogël, t'a kapshin ma me zell çashtjen e çimelit ndë fjalë.
U desh do kohë djeri që ata, të cilët kishin punë ndë dorë, t'a kuptojshin randësin'e dokumentit dhe t'a shndrojshin ndë realitet dëshirin e vullëndetmirëvet.
Sigurisht, jo porsi ma kompetenti, por…s'e dij; ndashti pse u dëftova aqë entuzjast, qeshë zgjedhë vetë për këtë misjon; d.m.th. të siellshem ndë tokën Shqipëtare, - mbassi s'ishte e mundunë kopjen origjinale, që njihet e vetmja ndë botë, - ndemose librin e fotografuem, që të mundshin kështu studjuesët e pastudjuesët me e kundruem pasqyrën e shqipes së folunë prej së parësh si në shekullin fill mbas deket së Skanderbeut.
nisa. Por, shi ate ma të parë natë ndë cilën mbërrina ndë Romë, krejt entuzjast për misjonin tem, m'u prish. Kur më qiti rasa t'ia përmendshem dikuj qëllimin, për të cilin kishem ardhë, m'a priti truq: "Edhe unë mirrem me kësosh punësh, jam hulumtues dokumentash së vjetër. Por, po kam keq të ju thom një fjalë: Kini ardhë ndë një kohë të keqe. Këso ditësh vapet, bibljoteka, me të cilën kini punë Ju, ashtë mbyllë, mbasi personeli gjindet i shpërndam ndër pushimet verore".
Ato fjalë më ranë si ujët valë. Me kaqë, ideali dhe entuzjasmi, me të cilin ishem nisë për këtë udhtim të jashtëzakonshëm, automatikisht binte poshtë. Shto shpenzimet, dhe… ma zi marrja, se dami. Misjoni im; barra m'e zhvorrue Buzukun, erdh e m'u pështjellue aqë, sa, për një ças u pendova, pse ia kishem hy ndopak.
Kishem ra, pse kështu kishem urdhën, ndë një monastir të përbam prej fretënsh spanjollë, vetëm prej kësish. Tashti, për fat temin aty banonte edhe nje frat piktor, i dërguem prej pronvinçës së vet, për të nxjerrun kopje nga origjinalet e kryevepravet të Pinakotekës[**] së Vatikanit. Artisti, A. Eugjeni ishte fort i njohtun ndër ato ambjente; kishte teserën me hy e me dalë pa taksë.
Ndë gjithatë demoralizim ku gjindeshem, m'u duk një ndërmjetës i aftë, për të më çelë shteg nd'atë punën teme. Prandej, unë, gjithëkund bisht mbas si. A. Piktori kishte aty ndër Muzejt e përmëndunë një zyrtar, kolegë të vetin; bashkëvëndas. Hapat e gjurmimit të parë i filluem te ky.
Para së gjithash na drejtoi te një rojtarësh së Bibljotekës, te një plak. Aty mormë vesht, se arkivet ishin gjithënjë çelë; edhe pamë vizituesët, që hyjshin e dilshin…M'erdhi fryma!
Bana si bana, e të nesërmen hyna edhe unë ndë Bibljotekë. Mirë se hyna, por ku do t'ua nisshem kërkesavet, unë, që, përposë emnit t'auktorit dhe të titullit të trilluem të Mesharit, nuk kishem kurrnjë shenjim tjetër?…Duhet me u gjetë mbrendë nd'atë pyllë të dendun librash e dokumentash, sikurse gjindeshem unë atë ditë për ma të parën herë ndë jetën teme, për të pasun iden, çka âshtë ajo Bibljotekë!
Më drejtuenë te sekcjoni i ungjijvet të vjetër: Dorëshkrime artistike apor inkunabula, të lidhunë shumica me lëkurë apor edhe ndër përgamene; disa, të mëdhaj sa unë ndë kambë. E e siellshem prej fundit mbë krye katalogun e atyne punimeve të vjetra: Ungjij gjithënduerë gjuhësh, ritit e stilit. Po, ç'dobi? Shqip, kurrgjâ, kurrkund!…
E vijova unë për do dit të mira ndër këto kërkesa të pafrytshme. Vijova djeri që një ditë m'a bani njeni rojtarësh: "D. Çiril Korolewsky, ai mirret me këso shkrimesh e botimesh së soçme liturgjike të kishëvet orjentale." – Edhe m'a dëftoi tavolinën ku punonte.
Por mjerisht aso ditësh, ndërsa unë ishem ndër grepa, tryeza e tij shihej gjithmonë thatë. Ku ishte D. Korolewsky?… Kishte shkue - më thanë - diku ndër rrethet e qytetit për pushime verore. Por, më siguruenë, se, mbas fjalës së lanunë, nuk kishte vonesë.
Edhe unë, për ditë nade, punën ma të parën, sa shkojshem ndë bibljotekë; me pyetë derëtarin, a kishte këthye D. Çirili!
Nuk kaluenë shumë dit njimend, edhe një rojtar m'a dha lajmin e gëzueshëm, se tek e mbramja i dëshruemi kishte mbërri natën para.
E prita. Për nji që më pau, m'a bani: "Po a Ju jini ai Frati nga Shqipënia, që më kërkoni tash një javë?… Buzukun lypni? Qe; më falni sa t'i ap fund njëkësaj letre që kam ndë dorë, edhe Jua pruna."
Të më kishte thanë, se m'ishte ngjallë prej vorrit njëni robësh së mi të dekunë, nuk e dij, se do t'ishem gëzue ma fort. Sa s'kjeshë tue i ra ndë gjuj përpara, me i puthun kambën. Kaq!
Tre minuta, nuk vonoi ma, për t'a krye atë shkresë, por mue m'atëherë, kur e kishem, si me thanë, Buzukun ndë grusht, ata minuta m'u duknë orë.
Dikur u çue, e la tavolinën; edhe, pa më thanë mue gjâ, shkoi e humbi mbas do raftesh së mëdhaj librash, sa… Nuk vonoi sa ndora, kur, si triumfalisht, m'a dorëzoi blenin e dëshruem.



Sa s'qava prej gëzimit. E mora ngrykë Buzukun e dashun, e putha me nderim edhe u vuna mbë tryesën e madhe të studjuesavet.
Edhe nisa t'a shfletsoj si i dëshruem me mall e poni, njashtu sikurse shfletohen letrat e shtrênjta të njëj miku të vjetër… Kaqë i kishem këcye përsypri atij visari të çëmueshëm, sa më bje ndër mendë, se njêni rojtarësh m'u afrue e më tha ndë vesh: "Ma kadalë! Këqyrni, mos t'a damtoni tue e shfletsue: âshtë gjâ e vjetrë -… Mandej jo vetëm me i vu duerët sypri!".
Kishte arsye, e pashë, të mi qitte ndër mendë rregullat ma elementaret e kētyne rasave; por, ç'ti bâjsh!… Unë atëherë kishem tretë faret, dhe s'dijshem ku ishem prej gëzimit e mallit.
Këndova mbë të sa këndova, djeri që u ba koha me i lirue salonat e leximit.
Njashtu edhe nd'e nesret e nd'e mbasnesrit; s'kishem të ngim. Një herë së parit rishtar i pamësuem me stilin dhe grafin buzukjane, ngurojshem. Por, menjëherë ia mora dorën leximit, dhe s'm'u bante ma me e lëshue.
Nuk e tora gjatë. Fill njaty të tretën a të katërtën ditë mbasi u këndaqa me të, u informova për fotografis-tin e bibljotekës. Më paraqitnë një farë Sansa-ini-t. Pashë modelat, i zgjodhmë, dhe ramë ndë godi për çëmim. Venduemë me i a hy punës pa tjetër: me fotografue krejt Mesharin, me m'a lidhë - dy kopje ndë lëkurë, njenën ndë rason. Për këto punime më kërkoi Stabilimenti nj'a tri javë afat.
Edhe unë ndë këtë ndërkohë e lashë Romën, e dola me kërkue ngjeti për dokumenta të shqipes.
Ndë krye të tri javëvet, t'u këthyemen ndë Romë, puna ma e para, m'u pjekë ndë fotografistin sypërmarrës. Stabiblimenti Sansaini i kishte ndejë përpikënisht kontratës. Kur m'i qiti me i pa blejt e lidhunë, më qeshi buza, ma fort zemra.
Sadoqë për dukë t'a kënaqshin synin, tue i shfletsue vërtetova, se reprodukcjoni ndër të tria kopjet nuk ishte ashtu i pastër dhe i qartë, si e kishem dëshruem. M'u prish pak. E po, thashë, cila vepër njerëzore mund të dalë prej doret së mjeshtrit krejt pa kurrnjë të metë a njollë? Por prap mendova, se njëni vend i mbyllët i kopjes **a)** mund te ndriçohej me tekstin e kopjes **b).**
Më kishte marrë mëndësh fotografisti me të lidhunt aqë elegant, sidomos t'asaj me rason; e… s'i bana ma fjalë.
U gëzova sa s'ka posaçe kahë mendojshem se me kaqë misjoni im kishte marrë një përfundim të mirë, e se tash mund t'u këthejshem ndë vend tem me ball hapët.
I dhashë drejtimin, të m'i binte ku rrijshem: SS. Quaranta. T'i marrmen ndë dorëzim "Buzukat" e lidhunë, aty për aty ia pagova sypërmarrësit punën: përsa më bje ndë mendë, nga 1200 lt. kopjen.
Tre blejt ndën sqetullë, me atë fill ngava të Libreria e famëshme "Desclée". I porosita të m'i impakojshin sa ma mir dhe të m'i sigurojshin me garansit ma të fortat të zyrës postare.
Ndërkaq i hoqa edhe vetë spirancat prej Romës edhe mora drejtimin kahë vendi im. Çka do të bajshem ma rrugash?
…. Një javë, nuk e besoj se vonoi ma tepër; edhe qe, se m'erdhi lajmi i zyrës së postelegrafës, që më njohtonte, se Buzukat kishin mbërri ndë doganën e qytetit.
Sa i vogël edhe unë!… Këndáqeshem tue i këqyrë ata tre blej. Si të kishem bâ një punë të madhe!



Origjinali i Mesharit e ekspozuar në Bibliotekën Qendrore, Tiranë

Justin RROTA (17.2.1889 – 20.12.1964): Filolog dhe gjuhëtar, klerik i Urdhrit Françeskan, Mësues i Popullit. Lindi në Shkodër, ku kreu dhe shkollën e mesme. Ndoqi studimet e larta teologjike në Austri. Në vitin 1911 u shugurua meshtar. Rreth 25 vjet qe mësues i gjuhës shqipe dhe i latinishtes në gjimnazin "Illyricum" në Shkodër. Pas luftës, duke qenë i sëmurë, jetoi në Kuvendin e Fretënve Françeskanë dhe si bashkëpunëtor i Institutit të Historisë e të Gjuhësisë u mor me studime gjuhësore si edhe me hartimin e veprës "Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore", që përfshin pjesë nga fonetika, leksikologjia, morfologjia, sintaksa dhe histori albanologjie. Kjo vepër e vëllimshme u botua nga Akademia e Shkencave dhe Provinca françeskane shqiptare (Shkodër, 2006). J. Rrota ka botuar shumë artikuj gjuhësorë dhe letrarë. Është marrë veçanërisht me gjurmimin dhe botimin kritik të teksteve të autorëve të vjetër, duke i transkriptuar e shoqëruar me komente. Ka botuar: "*Monumenti ma i vjetri i gjuhës shqype - D. Gjon Buzuku*" (1555)" (Shkodër, 1930, 1938); "*Shkrimtari ma i vjetri i italo-shqyptarvet - D. Lukë Matranga*" (1592)" (Shkodër, 1931, 1939); "*Analyzimi i rasavet t'emnit e zhvillimi historik i tynve*" (Shkodër, 1931); "*Për historín e alfabetit shqyp*" (1936); "*Syntaksa e gjuhës shqype* për shkollat e mesme" (1942, 1944). Nga fusha e historisë së letërsisë botoi "Letratyra shqype" (1925, botimi i plotësuar 1934). Si letrar ka botuar një përmbledhje me tregime, novela, kujtime "Rreth votrës" (1945). "*Hulumtime dhe shënime mbi Gjon Buzukun*" (në "Buletin për Shkencat Shoqërore", nr. 3, 1956, f. 173–187). J. Rrota është i pari që solli në Shqipëri, më 1929, tri kopje fotografike të "Mesharit" të Gj. Buzukut dhe u mor vazhdimisht me studimin e gjuhës së këtij autori. (Sipas "Fjalor enciklopedik shqiptar").

Shkrimi më poshtë është botuar së pari më 1955 te rev. "Nëndori" (nr. 3, f. 76-79) me rastin e 400-vjetorit të "Mesharit" të Gjon Buzukut (1555 – 1955). Në mars të atij viti Instituti i Shkencave organizoi një konferencë përkujtimore për Gjon Buzukun dhe shkrimtarët e tjerë të vjetër shqiptarë. Prof. Eqrem Çabej u ngarkua ngas Instituti për të përgatitur botimin kritik (d.m.th. me hyrje studimore, shënime e komente) të veprës së Buzukut. Për shkak të vështirësive teknike të shtypjes së një vepre të tillë në shtypshkronjat e vendit, botimi i veprës në dy vëllime u realizua me cilësi të lartë vetëm më 1968 në Bukuresht nga Akademia e Shkencave e Rumanisë.

Përjetimet dhe emocionet që provoi Justin Rrota në verën e vitit 1929 dhe që i ka shprehur aq bukur në këtë skicë letrare e dokumentare, i riprovojmë edhe ne sot, duke e soditur përmes xhamit librin e parë shqip të shtypur, po pa na u lejuar ta prekim, si dikur atë Justini. "Meshari" mbetet një monument madhështor i guximit intelektual shqiptar, i dashurisë së Gjon Buzukut për gjuhën shqipe dhe për popullin e vet, të cilit ia kushton këtë vepër. Ai e nisi punën më 20 mars 1554 dhe e përfundoi më 5 janar 1555. Vepra ka pasur 220 faqe, por në kopjen e vetme që ka arritur prej saj, kanë mbetur vetëm 188. Për fat të keq mungojnë faqet e para, ku shënohet vendi i botimit dhe autoriteti që lejon botimin. Prandaj kjo çështje mbetet ende e pazgjidhur.

Shkruan prof. Dr **Emil Lafe**

Shënimet:

[1] Të vihet re se J. Rrota nën ndikimin e sintaksës së Gjon Buzukut lakon disa herë edhe mbiemrin bashkë me emrin: *librit ma të vjetrit* (e ashtuquajtura dukuri e biflektizmit).
[2] Italisht *cimelio* "send i çmuar për vjetërsinë e tij dhe për përkatësinë në një epokë historike të veçantë, antikë, relike"
[3] qeshë zgjedhur unë (d.m.th. prej një instance eprore).
[4] pikërisht natën e parë…
[5] *Provincë* - qark kishtar (në organizmin e kishës katolike) që përfshin disa dioqeza dhe drejtohet nga një arkipeshkop.
[6] *mbas si* – mbas tij (*si* – formë e vjetër e rrjedhores së përemrit *ai*).
[7] *incunabula* quhen librat e shtypur në shek. XV, kur sapo kishte nisur arti i shtypshkrimit, pas shpikjes së J. Gutenbergut më 1445.
[8] *Poni* (greqisht) "dhembshuri".
[9] Riprodhimi fotografik, fotografia e tekstit të "Mesharit".
[10] Posaçërisht, sidomos.
[11] Fjala *drejtim* është përdorur sidomos në gjysmën e pare të shek. XX me kuptimin "adresë"
[12] T'i paketonin.

Suzuku 38/2012

Me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë

Dalja masive biblike në maje të Rumisë

Shkruan **Bahri Brisku**



Dalja e shqiptarëve në Rumi është traditë e kamotshme. Shqiptarët të lidhur me këtë bjeshkë të shenjtë, kanë krijuar shumë vlera poetike dhe legjendare. Popullata e Krajës, sidomos ajo e Briskut, Ljares dhe mbarë Shestanit e adhuron bjeshkën e Rumisë si festën (reliken) më të shenjtë kombëtare. Me shekuj gjatë pranverave shqiptarët e Krajës tuba-tuba, janë ngjitur lart në majën e Rumisë, ku me këngë e valle e lojëra sportive kanë shënuar kremtime të mrekullueshme.

Situatat e turbullta politiko shoqërore, shpërngulja masive dhe gjendja e pafavorshme ekonomike patën shkaktuar që vite të tëra nuk ka qenë bërë një organizim i mirëfilltë për vazhdimësinë e traditës së lashtë rreth piknikut popullor në bjeshkën e madhërishme të Rumisë.

Më 18.06.2005, në majën e Rumisë u vendos një lloj montazhi, rapullinë e shëmtuar – t kisha ortodokse serbe nga ana e priftit të tyre Amfillohijes.

Popullata shqiptare e Krajës e më gjerë e pat humbur entuziazmin e kremtimit të daljes në Rumi. E kërkoi kjo popullatë që kjo "konservë" montazhe të largohet sa më parë prej kësaj bjeshke. Por pushteti përveç premtimeve që do të e largojnë këtë objekt i cili është vendosur aty pa të drejtë dhe pa leje urbane, mbeti vetëm premtim që i ngjanë hipokrites institucionale e të ish pushtetit.

Duke vërejtur që ky objekt është vendosur në Rumi me qëllim konfliktuoz, për pengimin e shqiptarëve të Krajës në vazhdimin e traditës së bjeshkës së shenjtë, një grup intelektualësh dhe bjeshkatarësh të kësaj treve vendosën që të vazhdojnë dhe të normalizojnë traditën shekullore të daljes ,masive në piknik për çdo të diel të dytë të qershorit (teksti i autorit më i gjatë do të botohet në libër).

Rumia, me dalë n'Rumi

N'Rumi isht dalë njëherë n'vjetë, t'diellen, ditën e Ërrshajve (Rrëshajve, Rushajave, Pesëdhetorja, Duhovi), 7 javë mbas Pashkëve. Isht dashë me u nisë natën për me mrritë n'mé t'Rumisë pa zbardhë drita, ashtu qi aty mé pritë daljen e diellit ditën e Ërrshajve. N'Rumi kanë dale t'gjidh, Shestanasit, Kranjantë, Mërkotas, si Katoliktë ashtu edhe Myslimantë, thotë Marku'j Niks[1]. Kyj hadet isht shum i moçem, disa mija vjet, i kohës ILIRE, hadet qi e ruejtëm na Shqyptartë deri tash[2].

1.*Dishmon* Markuj Niks Pjetrit-Dedonj, Krythë, Ulqin.
2.*Shih* Tirta Mark, Mitologjia ndër Shqiptarë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2004:75-82. *Përgatiti* SGjDobreci.





1 Aleksi Pjetrit Macit Niks Martinoviq
2 Dritan Hamdi Rexha
3 Liridon Milla
4 Ajet Rexha
5 Memli Kurti
6 Vahid Ceni(fotografi)
7 Xhafer Cuka
8 Arlind Muja
9
10 Ardan Muja
11 Valdet Kurti
12 Xhemal Peroviq
13 Ilir Muja
14 Muradije Tahiri
15 Fisnik Dobreci
15a Indrit Koçi (Burrel)
16
17 Zef Gjon Lucit Kovaçit (Pema)
18
19 Naser Halili
20
21 Rrok Lulgjuraj
22 Rasim Gjenoshi
23 Senad Hasan Kollari
24 Miradin Ceka
25 Neriton Ceka
26 Xhelal Muja
27
28
29
30 Bajram Gjelloviq
31
32 Dragani Pjetrit Macit Niks Martinoviq
33 Valon Hoti
34 Islam Hoti
35 Muhamet Kollari
36 Mirsad Markashi
37 Gani Ceka
38 Hasie Muja
39 Paskale Martinoviq
40 Valeta Martinoviq
41
42
43 Egzon Muja
44
45
46 Emir Gjençiq
47
48
49 Muho Dushkiq
50
51
52
53
54 Fadil Gjelloviq
55
56
57
58
59 Idriz Gjelloviq
60

Një pjesa e grupit bjeshkatarve si dolën në maje të Rumis me datën 10.06.2012 me rastin e 100 vjetorit të pavarësis

Teksti i memorandumit të Shestanasve*

Memorandumi i shestanasve i dorëzuar deputetit Mustafa Merlika Kruja në Tiranë më 10 prill 1942

“Na, të nënshkruemit, përfaqësuesa dhe të dërguem të posaçëm nga popullsia e qytetit të Tivarit, të Ljarës, të Shestanit dhe të rretheve të këtyne qendrave, me autorizim të popullatës që përfaqësojnë, kemi nderin të formulojmë revendimet kombëtare që vazhdojnë:

1.Tash që fati i kombit shqiptar deshi të na fal mundësinë e një rikqyrjeje të vijës së përparshme të kufijve të Shqipnisë me ato të Malit të Zi, popullsia që përfaqësojmë, kërkon ndërmjet tonë, një të drejtë që u përket: ndreqjen e të tana padrejtësinave, që u kryen në të shkumën e afërt, kundrejt nesh. Don me thanë:



A:Shpërnguljen, pikë së pari, të shenjave të tashme të kufijve tanë, pikave ku ndodheshin vijat e kufijve në vitin 1878, kur padrejtësia e Kongresit të Berlinit, në nji anë dhe bashkëpunimi i Turqisë me ta, në anën tjetër, i detyruem me anë të forcës dhe nëpërmjet të një demonstrate të madhe detare të luftanijevet e të gjithë fuqive të mëdha të atëhershme, Zoqtë e Shqipës t'i përulen, mbas një gjakderdhjeje të tmerrshme, gjatë së cilës shqiptari diftoi burrërisht se sa e çmon lirinë, lakmisë së pa ngopur shkjenore.

B.Ljarja e Shestani, që janë pjesë integruese të kësaj zone thjesht shqiptare, duhet të përfshihen, njiheri, brenda kufijve të Shqipnisë etnike pse, edhe jeta e tyne pa Tivar brenda gjinit të atdheut shqiptar, asht kryekëput e pamundur. Njëra anë kërkon tjetrën: Ljarja e Shestani, të banueme prej nji popullsie qind për qind shqiptare, kërkojnë, këndej kufijve të Shqipnisë, qytetin e Tivarit me gjithë skele pse edhe Tivari, i shkëputun aq padrejtësisht nga Shqipnija, asht tokë shqiptare...

Ne lypim që të bëhet menjiherë nji plebishit. Mund të garantojmë me siguri të plotë se rezultatet e këtij plebishti do të jenë në pajtim të plotë me parashikimet tona.

II.Qëndrimi i kësaj popullsie andej dhe këndej kufijve të tashëm të Shqipnisë, ashtë kryekëput i kuptueshëm dhe përban, vetvetiu një provë të shkëlqyeme të vullnetit të saj për të qenë pjesë e Nanës së përbashkët, e Nanës Shqipni. Asnjë burrë shqiptar andej kufijve të tashëm edhe me shtrëngesë, nuk ka pranuar të rrokë armët bri për bri me malazezët kundër Shqipnisë dhe shqiptarëve. Ata kanë pritë e presin pa durim ditën e lirimit, ditën e bashkimit me Shqipninë. Ndër të gjitha mbledhjet dhe kuvendet e organizuara në Ljare dhe në Shestan, qyteti i Tivarit ka qenë kurdoherë i përfaqësuar dhe, në çdo rasë, ka kërkuar që, përfaqësuesit e Ljares dhe të Shestanit, që kanë ardhur aq shpesh në kryeqytetin shqiptar, bashkë me të drejtat e tyne, të kërkonin, në emër të popullit të Tivarit, për t´u bashkue me Shqipninë.

Do të ishte, pra, nji faj të lihej Tivari andej kufijve të Shqipnisë.

III. Ljarja e Shestani, që tash ndodhen as andej as këndej kufijve, kanë dhënë, gjithashtu, prova të gjalla të vullnetit të tyne për bashkim me Shqipninë, ndonëse vija e kufirit i la jashta gjinit të Atdheut këto krahina kreshnike, ku gjuha e Kastriotit ashtë e vetmja gjuhë që tingëllon ndër vende e kryevende.

Në gusht të viti 1941, kur shpërtheu kryengritja antimalazeze, u dëbuan prej vendeve të tyne autoritet civile dhe ushtarake malazeze e, mes brohoritjeve të përbashkëta e të gjithë popullit, u ngrit, në mes të një gëzimi të papërshkrueshëm, flamuri kombëtar shqiptar përbri atij të Italisë. Edhe ndër kohët e fundit, kur rreziku malazez po përtrihej, burrat e Ljares dhe të Shestanit u gjetën rishtas gati për t'u rradhitun në mbrojtje të vendit...

Përfaqësues të zgjedhun nga popullsia e Tivarit, Ljares, Shestanit dhe të rrethinave të varuna prej tyne, kërkojnë nxehtësisht që, këtë herë, rikqyrja e kufijve të sjellë drejtësinë e plotë për të gjithë shqiptarët e mbetun në Mal të Zi: bashkimin e Tivarit, Ljares dhe Shestanit me gjithë rrethe me atdheun shqiptar. Ky është pikë për pikë vullneti i gjithëmbarshëm i të tanë shqiptarëve e ky vullnet duhet të jetë edhe baza themelore mbi të cilën mbështetet caktimi i vijës së re të kufijve të Shqipnisë. Popullsia që përfaqësojmë, të bindun thellësisht në drejtësinë e çështjes së tyne, besojnë se zëri i tyne do të dëgjohet fisnikërisht nga ana e juaj: aspiratat e tyne do të kunorëzohen me përmbushjen e plotë të kërkesave të tyne të drejta “. Tiranë, më 10 prill 1942

Marrë prej Buçinca Fahri, Cafo Beg Ulqini, Atr Club, Ulqin 2009:100-1.

Što su Šestani izgubili u procesu slaviziranja

Šestani, posebno oni koji žive u Baru, ali i dio njih u inostranstvu, ne čuvajući svoj identitet, izgubili su niz veoma dragocjenih nacionalnih, etnokulturnih, pa i ličnih vrijednosti.

1. Izgubili su svoj **iliro-arbanaško-albanski jezik**, kojega su njihovi preci govorili, ne stotinama, nego hiljadama godina. Albanski jezik je jedan od najstarijih evropskih jezika, a, po nekim naućnicima, çak najstariji. Albanski jezik ima izvanrednih vrijednosti na polju linvistike. Jedan je od najinteresantnijih jezika po svojem leksičkom bogatstvu, po svojoj morfologiji, osobito u glagolskom sitemu i u sistemu zamjenica i pridjeva, te po svojoj sintaksnoj strukturi itd. Ne mali broj albonologa, naroçito austrijski i njemački, ali i danski, francuski, američki, ruski, izražavaju se veoma zadovoljnim i ponose se što su imali sreću da proučavaju upravo jezik Albanaca.

Govor Šestana, kao sastavni dio prastarog albanskog jezika, predstavlja jedno od najdragocjenijih blaga ovoga jezika. Šestani çuvaju u svom dijalektnom govoru, toliko drevnih elemenata, da prosto nema albanskog ili stranog jezičara, koji se bar prolazno nije zanimao i sa ovim govorom.

Ima ih na desetine lingvista koji su se, ispitivajući početno govor Arbanasa kod Zadra, prijatno iznenadili kada su naišli u Šestanima, prapostojbini zadarskih Arbanasa, na veoma interesantne jezičke oblike, veoma vrijedne za istorijsku gramatiku albanskog jezika. Međutim, Šestani, ne upotrebljavajući već nekoliko decenija ovaj svoj jezik, odriču se jednog izvanrednog etnokulturnog blaga. **Jezik je jedno od najdragocjenijih blaga bilo kojeg naroda**. Taj koji ubija svoj jezik, praktično ubija sebe.

2. **Folklor Šestana** je bio takođe izvanredan, sa nezamjenjivim vrijednostima ne samo u albanskom folkloru, nego i u evropskom. Narodno **prozno stvaralaštvo**, koje se nažalost nije sakupilo i objavilo, bilo je izvanredno bogato i veoma privlačno stvaralaštvo. Iznenađujuće za naučnike, ali i zabavno za obične ljude. Kada su se Šestani sakupljali veçerima na sjelo, pa kad bi se zapleli u svojim tradicionalnim razgovorima, nijesu se razilazili na spavanje do kasno u noći, slušajući raznorazne priče, zagonetke i anekdotska kazivanja. Narodne poslovice i zagonetke bile su vaspitna i zabavna ishrana kako za djecu, tako i za odrasle. Bila su to savršena umjetnička djela, pa je prava kulturna bijeda što su ta djela vremenom isčezla a sve to zbog toga što su Šestani nemudro podlegli slaviziranju.



Šestansko kolo u Ulcinju

Narodne šestanske pjesme su opet jedan od blaga nenadoknadljive vrijednosti, ne samo u albanskom, nego i u balkanskom i evropskom folkloru. Posebno izvjestan broj šestanskih **balada** čuvaju u sebi remiscentnih elemenata još iz Antikiteta. Što znači: Čuvaju u sebi pomen životnih pojedinosti od prije 3000 godina. Nigdje se nije sačuvala ta vrsta balade kao u Šestanima. Ne samo po jako privlačnoj tematici, nego i u umjetničkom smislu, šestanske balade su u pravom smislu savršena umjetnička djela. Izvrstan osmerac, izrazito impresivni slikoviti izrazi, besprekorne u pogledu kompozicije, dobar dio šestanskih narodnih pjesama predstavljaju prava poetska remekdjela. Može se slobodno reći da se albanska folkloristika ponosi sa baladama koje su se doskora sačuvale u Šestanima, međutim, sami Šestani, u nemogućnosti da se brinu o toj svojoj kulturnoj imovini, usled slaviziranja, izostavljajući i zaboravljajući te svoje prelijepe balade, ni sami ne znaju koliko su od toga izgubili.

4. **Šestansko Kolo** se ocijenilo kao jedna od najstarijih albanskih koreografskih vrijednosti. Njen kružni oblik, naizmjenično pjevanje, prvo muškarci zatim žene, ili obratno, veoma prost ritam, svjedok svoje starodrevnosti, sve ovo i mnoge druge osobine čine Šestansko Kolo zaslužnim da se proglasi od međunarodne organizacije UNESCO-a imovinom sveljudske vrijednosti. Šestansko Kolo se može igrati neprekidno, smjenjujući se igrači kad god se umore ili nasite pjevanja, ređajući jednu za drugom bezbroj pjesama. Ova iznenađujuće čudna osobina čini Šestansko Kolo izvanredno privlačnim za svjetske folkloriste, jer se rijetko koje kolo može voditi takoreći besprekidno 5 sati, pa i 10 sati, ako je veselje prigodno. Budući da je to kolo bez sumnje naslijeđeno još od Antikiteta, a preživjelo mileniume sve do XXI vijeka, ono čuva istodobno i zavidnu prirodu demokratije, donijete čak iz tih vremena. Uzrasti su u tom kolu potpuno ravnopravni. Pjevaju svi zajedno od 70-godišnjeg starca do 7-godišnjeg dječka ili djevojčice. Pjevaju se u istom kolu kako stare pjesme, tako i ljubavne, kako satirične, tako i tragične. U Šestanskom Kolu, kao potpuno ravnopravni, igraju zajedno i muškarci i žene, što predstavlja posebnu vrijednost, zbog toga što se u ovom kolu ne ogleda uticaj orijentalne osmano-turske kulture. Šestani su, u procesu slaviziranja, izgubili svoje kolo, a zajedno sa kolom i njegov dragocjeni repertoar. **Pjesme koje su se pjevale u tom kolu ne mogu se ponoviti u nijednom drugom jeziku**. One moraju izumrijeti zajedno sa jezikom na kojem su se vjekovima pjevale.

5. U pogledu svoje **narodne nošnje**, tursko osvajanje i turska vlast nije mogla ništa bitno promijeniti u Šestanima. Međutim, osvajanje Šestana od strane Crne Gore u godinama 1877-1878. učinilo je da se muška nošnja izgubi do te mjere da ju je danas veoma teško restaurirati u elementima po kojima se ona razlikovala od nošnji ostalih predjela Albanije. Ipak, nošnja žena i djevojaka uspjela je da se sačuva do današnjih

dana, ali u Baru, tamo gdje se slaviziranje Šestana realizuje tako reći na drastičan način, i ova se nošnja već napustila. U vremenu kada se evropski i svjetski narodi trude da iznova pronađu i sačuvaju svoje nošnje kao dragocjene relikte, mi koji smo tu nošnju čuvali hiljadama godina, gubimo je upravo sada, na zaista neoprostiv način.



Gabriela Simoni i Viktor Lukić daruju cvijeće predsjedniku Albanije, g.Bujaru Nishaniju

6. U procesu slaviziranja ali i zbog iseljavanja, zbog napuštanja svojeg pradjedovskog zavičaja, Šestani gube još jedno nezamjenjivo blago. Skupina **imena mjesta**, to što se u nauci naziva **toponimija**, sačinjava posebno polje, izvanredno interesantno u svrsi ispitivaja na polju kulture bilo kojeg etniteta. U Šestanima je toponimija bila, koliko zbijena (Nije postojalo kamena i drveta bez svojeg osobnog imena.), toliko i interesantno u jezičkom pogledu. Interesantno, jer je često čuvalo u sebi toliko drevne oblike, da se razna imena mjesta mogu uporediti sa stvarima koje otkriva i studira arheologija. Ali je i tu ubitačno djelovao proces slavizacije. Veliki broj toponima se prosto preveo na crnogorski jezik, ili se prilagodio na taj način, da je sada uopšte nemoguće odrediti porijeklo.

7. Poslovi raznih **majstorija i zanimanja**, zajedno sa svojim karakterističnim rječnicima, počev od stočarstva, obrade zemlje, do gradnje ubala, pokrivanja koliba, izvanredno starih po tipu i obliku, vršidbe, gradnje čamaca i načina lovljenja ribe, sve su to Šestani izgubili, ne samo iseljavanjem, nego i neodgovornim napuštanjem svojeg **maternjeg** jezika. Ne smijemo zaboraviti da, kad kažemo ***maternji***, ne podrazumijevamo samo "svoju rođenu majku", koja ne mora biti iz Šestana, nego podrazumijevamo dugi niz majki od očeve i majčine majke do ko zna kojeg pokoljenja, prije stotinu ili pet stotina godina. To je matenji jezik, a ne jezik koji učimo u školi ili putujući vozom. Šestani su, nažalost, posebno oni u Baru, taj jezik tragično izgubili.

8. U vezi sa **školovanjem**, ne školujići svoju djecu na svojem jeziku, dakle na albanskom jeziku, Šestani su totalno izbrisali svoju prošlost i kaznili su mlade generacije da ostanu u potpunoj ignoranciji što se tiče poznavanja samog sebe. Šestani danas mogu završiti bilo koju visoku školu, ali ne znaju ni ko su, ni što su. Ne poznaju svoju istoriju i istoriju svoje nacije. A ta je naša istorija, istorija Albanaca, toliko prepuna zbivanjima, i svijetlih i tragičnih, i toliko dugovječna, da se bilo koji pripadnik jedne takve istorije ne može a da se ne osjeti važnim subjektom među sunarodnicima.

9. Slavizirajući se u XX vijeku, upravo u vremenu kada se svi narodi trude da čuvaju i da afirmišu svoj identitet, Šestani su izgubili najdragocjenije što čovjek može imati: **Ponos** i pravo da se pred drugima predstavlja da je i on neko i nešto. Ne niko i ništa, nego neko i nešto. Crnogorci, mada mlada nacija, koja se počela kristalizirati tek u XV vijeku, ipak imaju svoje bitne osobine. Imaju tradiciju svojih plemena, imaju svoj poseban jezik, svoje folklorno stvaralaštvo, svoju istoriju, posebno istoriju odupiranja i ratovanja protiv turskih ugnjetača, imaju najzad i svoju tradicionalnu crkvu na svome jeziku. **Šestani nipošto ne mogu naći sebe u sastavu crnogorske nacije**. U sklopu crnogorske nacije Šestani ne predstavljaju baš ništa. Oni, u sastavu te nacije, ne mogu predstavljati ništa drugo osim nekog amorfnog i neodređenog življa. Razlikuju se od crnogorskih plemena, jer nemaju sa njima ništa zajedničkog.

Možeš biti dobar čovjek, možeš dobro vladati svojom profesijom, možeš biti po prirodi vrlo spretan i vješt čovjek, ali kad tvoj sagovornik sazna da mu ti kriješ prošlost svojih djedova i nacionalnu pripadnost, on te nikako neće cijeniti ravnopravim. Naprotiv, on te mora smatrati hipokritom.

Čak ni u **vjerskom** pogledu Šestani, slavizirajući se, ne predstavljaju gotovo ništa. Barska Nadbiskupija je vjekovima čuvala i jezičke i kulturne vrijednosti svojih vjernika Šestana, ali, u procesu slaviziranja, tu je nestalo gotovo sve od nekadašnje devocije. Novo pokoljenje šestanskih vjernika nije u stanju praktikovati čak ni svoje vjekovima tradicionalne molitve, a kamo li nešto drugo što je bitnije: Katekizam, obred sakramenata i samosvijest da je njihov rod katolički star najmanje 1300 godina. Molitve prevedene na slovenskom, nijesu crnogorske nego hrvatske. Na ulazu u katedrali stoji natpis: ***Za Boga i za svoj narod***. Ali praktično, čim se tu ne čuju ni molitve ***Ati ynë*** (***Oče naš***) i ***Falemi Mri*** (***Zdravo Marija***) na svom jeziku, tu se ništa ne može uraditi "***za svoj narod***".

10. I najzad, u procesu slaviziraja, Šestani su izgubili u svemu, ali najviše **u političkom pogledu**. Ako bi se sinovi i kćeri Šestana školovali na svojem jeziku, kao što su se školovala djeca drugih albanskih krajeva, danas bi oni bili na visokim nivoima i u političkom pogledu. Ako bi se školovali na albanskom jeziku, oni bi danas zauzimali važna mjesta i u crnogorskom parlamentu i u crnogorskoj vladi. Bili bi veoma važan subjekat u baskoj i u ulcinjskoj opštini, takođe u Podgorici i drugdje. Bili bi takvi, jer bi predstavljali sebe. Međutim sada, potčinjavajući se slavizaciji, oni iz dana u dan gube i od svoje ličnosti i od svoga bića. A zna se da ko nema svoje sobstvene ličnosti, svoj personalitet, taj nikada ne može da bude nikakav važan subjekat da se uzme u obzir. **Kao posledica svega ovoga, nažalost, danas niko ne računa na Šestane.**

Gjokë Dabaj, iz Šestana, opština Bar; u Draču, 29 Novembar 2011.



Šestansko kolo u Skadru

Shqiptarët në veprat e Andreja Kaçiq-Mioshiqit

Poeti popullor kroat i shekullit XVIII, françeskani Andreja Kaçiq-Mioshiqi (17.04.1704 - 12.12.1760) në veprat e veta ka përshkrue jo vetën historín sllave, por edhe ate shqiptare. Personi i


Andrija Kačić Miošić (17.04.1704–12.12.1760)

Andreja Kaçiq-Mioshiqit âsht shum interesant. Ka lind në Brist te Makarska, kurse ka vdekë në Zaostrog. Studimet teologjike i ka krye në manastirin Zaostrog dhe Buda dhe thuhet se ka shkue për studime edhe n'Itali. Në vjetin 1752 âsht gjetë në Vevedik si klerik françeskan, ku ka shtyp në latinisht veprën e vet "*Elementa peripatheticae*". Por, mâ vonë me veprën e vet "Biseda e kândshme e popujve sllavë" (Razgovor ugodni naroda slovinskog, 1756) âsht bâ i njoftun dhe jashtëzakonisht i dashtun në publikun e gjanë. Mjafton me thanë se kjo vepër ka pasë mâ se 50 edicione (botime). Âsht shkrue dhetërrokësh dhe në gjuhën e popullit, në vargun e poezís popullore sërbe dhe kroate.
Përmbajtja e "Bisedës së kândshme..." âsht historike. Landën për vargjet e tij dhetërrokëshe Kaçiqi e ka marrë prej kronikave të ndryshme latine dhe italiane si dhe veprave latine. Përveç kësaj, Kaçiqi ka udhëtue mjaft dhe âsht përpjekë me njoftë gjuhën e popullit. Sado që nuk kemi informata arkivash për t'ashtuquejtunat udhëtime zyrtare të Kaçiq-Mioshiqit, nëpër Bosnë e Hercegovinë, prapë se prapë disa biografë të tij thonë se ai ka njoftë mirë jetën e popullit dhe doket e tija, pikërisht për hir t'udhëtimeve të tija. Edhe vetë poeti thotë se ka shtegtue me lahutë: "Prej Shkodre deri në Zara (Zadar) e prej Mostari deri në Kotorr".
Kaçiqi, padyshim, ka pësua edhe ndikimin e legjendave dhe të folklorit popullor. Veprat e veta në kroatishten Kaçiqi i ka konsiderue si punë arsimore. Ai këto vepra i ka shkrue "për bujqit e barinjtë e vorfun" të cilët nuk e njohim gjuhën latine.
Vepra mâ e randsishme e Kaçiqit "Biseda e kândshme e popujve sllavë" âsht nji lloj historije e paraqitun me anë vargu dhetërrokësh. Mirëpo shum detaje janë dhanë ashtu sikur ka pasë dëshirë me i pa vetë poeti.
Në kohën e Kaçiqit ka qenë jashtëzakonisht aktuale ideja e çlirimit prej Turqvet. Edhe Kaçiqi, si klerik katolik, ka qenë nji propagandist i madh i luftës kristiane kundër Turqvet.
Tue parashtrue ngjarjet e shekullit XV e këndej, Kaçiqi âsht përpjekë që ta ngrehi sa mâ tepër luftën e të kështenvet kundër Osmanlivet. Këtu ka ndeshë edhe në historín shqiptare, sidomos në betejat e Gjergj Kastriotit-Skenderbeut. E gjithë pjesa e parë e veprës së përmendun "Biseda e kândshme..." me nja 50 artikuj dhe me nja 20 vjersha dhetërrokshe i âsht kushtue "ushtarit të Jezu (Krishtit) **Gjergj Kastriotit, të quejtun Skenderbeg**, **princit të Shqiptarëve dhe t'Epirit**".
Burimet e jetës së Skenderbegut, thotë Kaçiqi, i ka nxjerrë prej veprave të ndryshme të shkrimtarëve latin dhe italianë, si: Sagreda, Giammaria, shkodranit Barleci, Breshaninit etj. Ndoshta, legjenda për Skenderbegun, e cila e përhapur në botën e krishtënve, ka ndikue edhe në Kaçiqin. Skenderbegu ende kërthi, bashkë me tre vllaznit, merret peng prej Turqvet. N'oborrin e sulltan Muratit, Skenderbegu dallohet për trimni. Mbas vdekjes së të jatit të tij Gjonit, Skenderbegu mendon për Krujën, të cilën duhet ta trashigojë. Çasti mâ i përshtatshëm qè ai kur duhej të sulmonte Ungarezët dhe Sërbët në betejën afër Nishit, të cilin rast ai e shfrytëzoi tue u marrë vesht me 'ta kundra Turqvet. Mbas kësaj përshkruhen beteja të shumta të Shqiptarëve në krye me Skenderbegun kundra Turqvet. Përveç Skenderbegut, në këto vargje përmenden edhe persona të tjerë pak a shum legjendarë si Zakaria Gropa, Ballabani, Ban Dukagjini, Musak Kapedani. Veçanërisht âsht paraqitë figura e gjithanshme e Skenderbegut.
Skenderbegu ka mbajtë lidhje edhe me sundimtarë të tjerë katolikë të Francës, Italís, Austrís. Simbas vargjeve të Kaçiqit, Skenderbegu madjè me të vetët "Shqiptarë idhnakë" merr pjesë edhe e grindjet e mbrendshme me shoqishoqin n'Italí. Megjithate mâsëmiri janë paraqitë betejat kundra Turqvet. Turqit përpiqen me nënshtrue me çdo mënyrë Skenderbegun dhe Shqiptarët. Përdorin trathtina, pusina, dredhina vetëm e vetëm që ta shtijnë në dorë Skenderbegun të gjallë. Por ,


Shpata dhe përkrenarja e Gjergj Kastriotit Skënderbeut ruhet në Vjenë, Austri



Skenderbegu dhe Shqiptarët, në veprat e Kaçiqit, janë paraqitë me atribute (vetí) madhështore dhe si heronj fort t'aftë.

Kaçiqi, në vargjet e veta, âsht përpjekë që Skenderbegun ta vejë në pah, mbi të gjtha, si nji të krishten dhe katolik të madh. Ai mbështetet n'aspiratat e veta në Papen e Italín katolike. Prandej edhe kur e përshkruen vdekjen e Skender-begut në Lesh (Lezhë) në vjetin 1467 prej etheve, Kaçiqi thotë se Gjergj Kastrioti ka ndrrue jetë në praninë e përfaqësuesit të Venedikut "Sepse, kur ia mërrini në qytetin e Leshit, iu vërsul sëmundja vdekjepruese, domethanë flaka e tërbueme, e cila e ngriti prej kësaj bote në nji mâ të mirë... Mbasi plotsoi ceremonín e rastit (shën sakramentin) thirri krentë shqiptarë dhe përfaqësuesin e Venedikut dhe filloi t'flasi kështu: A i dini mirë, more burra të Shqipnís, dredhít e Turqve... E keni njoftë pabesín e tyne, ndjekjet dhe urrejtjen e madhe kundra të kështenve. Ju la amanet harmonín dhe qetsín, dhe mbahuni të bashkuem dhe të harmonishëm në luftë kundër anmikut të përgjithshëm, sepse mosbashkimi i mbretënve dhe princave të krishten âsht themeli për ngritjen dhe shtrimjen e Turqve."

Kur të hiqet elementi religjioz prej veprave të Kaçiqit, i cili âsht i kuptueshëm për nji klerik katolik, prapë se prapë mbetet nji pjesë e gojëdhanës dhe e së vërtetës mbi nji periudhë shum të randsishme dhe të lavdishme të së kaluemes shqiptare.

Thuhet se vepra popullore e Kaçiqit "Biseda e kândshme ..." si dhe vepra tjetër në gjuhën popullore ("Karabljica", 1760) âsht lexue edhe në Metohí. Për veprat e Kaçiqit janë interesua edhe shum shkencëtarë dhe letrarë të huej. Edhe shkodrani Pashk Bardhi, françeskan, e ka pá të vlefshme me përkthye prej veprës së Kaçiqit vargje mbi Skenderbegun dhe betejat e Shqiptarëve kundra Turqve. Ndoshta vargjet e Kaçiqit kanë ndihmue shum që të kuptohet mâ mirë historija dhe njerëzit fqinj të popullit shqiptar dhe kështu kanë ndihmue n'afrimin reciprok. Prandej këte moment duhet me e v? në pah nga harrueshmënija e së kaluemes dhe me e nënvizue sidomos sod.

Shkruen Dragutin MIQOVIQ

Marrë nga **ZANI I RINIS** vjeti IV, nr 5-6, 1 maj 1956:7.

Një diasporë shembullore në Itali

Shkruan **Dom Gabriel Grabanica**

Diaspora shqiptare është sot një faktor i rëndësishëm si në vendin ku jetojnë, e po ashtu edhe për vendin prej kah kanë ardhur, për çka dëshmojnë shumë shembuj nga mbanë bota. Një shembull është diaspora shqiptare në rajonin e qytetit Lecco (Leko) në provincen e qytetit të Milanos në Itali. Në këtë qytet, gjatë vizitës tri ditëshe (5-7 tetor 2012) që pata, isha i impresionuar për jetën aktive të një komuniteti shqiptar.



Stublla e Vitisë, jo shumë e populluar, fshat i Kosovës, kanë emigruar shumë, dhe tani jetojnë vetëm në qytetin e Lecco-s më rrethinë mbi 1200 persona. Edhe Shqiptarët e Malit të Zi e njohin varrën e emigrimit, të cilën po e vuajnë edhe sot.

Jeta dhe veprimtaria e këtyre shqiptarëve që jetojnë në Leko është shembull se si mundet diaspora në mbarë botën të integrohet dhe njëkohësisht ta ruaj identitetin kombëtar. Shoqata "STUBLLA" është emri i fshatit prej kah ata kanë ardhur. Me rastin e përvjetorit të ekipit "Stublla City", kryetari e të cilit ishte Kristjan Ramaj, u organizua turniri futbollistik më 6 tetor 2012, ku mori pjesë edhe ekipi "Bijtë e Shestanit" të famullisë Braticë – Kullomzë.

U nisëm prej Ulqinit, përshkuam Kroacinë e Slloveninë dhe arritëm në Itali në qytetin piktoresk Leko, buzë liqenit Komo. Pritja ishte vëllazërore nga baca Pashk Ballabani, burrë flokëthinjur; mikpritja e tij e meriton nderimin që bënin i madh e i vogël. Shtëpia e Pashkut ishte e të gjithë shqiptarëve, vend frymëzimi dhe ideve për të mirën e kombit. Në një darkë vëllazërore, me ne u bashkuan edhe shumë bijë dhe bija të këtij vendi. Shumë bijë dhe bija që jetonin dhe vepronin tash e sa vite në atë vend u bashkuan me ne në një darkë vëllazërore.

Baca Pashk na njoftoi për ndihmat e diasporës për Kosovën, sidomos për Stubllën, p.sh ndërtimi i shkollës, fushës sportive, rinovimi i Kishës. Kristjani na rrëfej për jetën sportive, sidomos të bijve dhe bijave të Stubllës. Turnirin sivjet e fitoj ekipi vendas "Stublla City", e ne të Ulqinit morëm çmimin si skuadra me e sjellshme e turnirit. Falë kësaj diaspore, e cila mund të jetë shembull për tjera, populli Italian ka formuar mendim të mirë për popullin Shqiptar. Nga mikpritësit u ndamë të kënaqur, se patëm rastin të takojmë vëllezërit tanë të ardhur nga qytetet tjera të Italisë, nga Kroacia dhe Zvicra, krijuam miqësi të reja, biseduam për mundësi bashkëpunimi, premtuan se do të vinë për ta vizituar vendin tonë.

Me rastin e 100 vjetorit Jubilar shqiptar përkujtojmë mësuesin **Gjergj** Nrekiqi**n prej Kllezne, Ana e Malit, Ulqin.**

Bisedë me Mrikën, bashkëshorten e Gjergj Nrekiqit

Bisedoi **magjistër Nikollë Shabani**

Zonja Mrikë, kur u martuat me Mësuesin Gjergjin, ku jetuat fillimisht?

Në Kllezën jetuam me Gjergjin në Kullën e tyre, ma të madhen në atë vend, Kullën e Preçajve bashkë me të gjithë antarët e afërm të fisit të tij, me babën e Gjergjit, Apen Simë, Dadën Tole, vllaun Pjetrin dhe motrat Lezen dhe Marijen, kushrinjtë e tyre Mati Preçin me dy djemtë Preçin dhe Rrokun. Rroku ishte i martuar me Prenen nga Muriqani dhe fëmijet e tyre ishin: Marku, Zefi dhe vajza Liza. Preçi me gruan Lenën ka djalin Matinë dhe vajzat Luçen dhe Manden. Me kushrinjtë e tij jetuam në bashkari deri me termetin e vitit 1968. Me Gjergjin u martuam në vitin 1949, poashtu në këtë vit Gjergji diplomoj në Shkollën Normale të Prizrenit dhe e fitoj titullin mësues. Por, Gjergji jepte mësim edhe më parë. Aftesitë e njohurive për të ushtruar detyrën e mësuesit i kishte të arritura më herët, por në veçanti edhe gjatë luftës dytë botrore kundër fashizmit ku dhe u plagos shume rëndë dhe nga kjo luftë u emrua oficer, prej në vitin 1945 deri në vitin 1948 jeton në Nikshiq ku ishte i angazhuar për arsimimin e kuadrit ushtarak pas Luftës.


Zonja Mrikë, ku ishte i punësuar mësues Gjergji gjatë kohës kur Ju jetonit në Kllezën?

Gjergji, më 1949 punësohet në Shkollën e Ciklit të Lartë në Anë të Malit, në të cilën ishte Drejtor Januz Divani, koleg mësues kishte Zef Shllakun,Petar Pavlloviqin etj.

Zonja Mrikë, ne e njohim jetën e mësues Gjergjit si intelektual,besimtar dhe humanist, cfarë mund të na thoni për këto vetitë e tija të spikatura?

Idealist i frymës së lirë, personalitet me moral të larte, mësimdhënës me pamje dhe sjellje pedante, Gjergj Nrekiqi edhe pas Luftës II Botrore punon në realizimin e parimeve të tija të cilët bazoheshin në edukimin e popullsisë vendase. I bindur se dituria dhe edukimi përbëjnë bazën e zhvillimit të së cilës shoqëri demokratike, në atë drejtim orijenton gjithë veprimtarinë e tij. Në veçanti i kushtohet barazisë në shoqeri dhe të gjithëve pa rezervë u ndihmon dhe i arsimon sa herë që e lypte nevoja. Mësimdhënës i cili pa kurrsuer vetën u ka ndihmuar njerëzve, ka qenë i adhuruar në mesin e popullit të vetë. Atë e kanë shikuar si shembull, njeri guximtar, i ndershëm dhe i ditur.

Madhësia e Gjergj Nrekiqit vjen në pah gjatë rrethanave të asaj kohe kur largohet nga Partija Komuniste Jugosllave dhe shpernguljа nga vendlindja. Në fakt, babai i Gjergjit, Sima, besimtar tradicionalist, çdo të diele shkonte në kishë. Grupacioni lokalist, të cilëve nuk u ishte në interes edukimi i popullit, por intereset personale (*pengu ma i rëndë është padituria*), Gjergjin e shpallin si antar i cili nuk i është besnik ndaj sistemit komunist jugosllav, pasi që nuk mund ta ndaloj babain të shkojë në kishë. Vendasit ishin të revoltuar me sjelljet e atyre të cilët donin që figuren e Gjergjit ta zbehin në syte e popullit.



Djathtas, mësues Gjergji (1921 – 1993; intelektual, besimtar dhe humanist), në mes kolegët e tij, mësues Palë Lucaj, majtas mësues Vat Martini-

Nxënësit e Gjergjit treguan guxim të pa masë për atë kohë duke bojkotuar mësimin në shenjë protesti dhe duke kërkuar që mësues Gjergji të kthehet në shkollë.

Edhe pse ishte akuzuar pa argumente, ai e perballon dhe e tejkalon atë problem. Gjergji edhe një herë e tregon madhësinë e tij duke mos njollosur askend, as edhe kundershtarët e tij më të rreptë. Pas kësaj Gjergji me familje shpernguIet në Kosovë.

Zonja Mrikë, a e keni menduar se do të ishte më mirë të kishit vazhduar të jetonit në Kosovë, apo më mirë që u kthyet me familje në Ulqin?

Në vitin 1955 shkuam në Kosovë. Gjergji në fillim u punësua në Vrellë dhe pas një viti në shkollën fillore “17 Nëntori” në Istog. Me hapjen e Gjimnazit “Vëllezërit Ribar” punësohet si profesor i biologjisë dhe i kimisë. Ne na pritën shumë mirë në Kosovë, fëmijët vazhduan mësimet me shumë suksese, poashtu edhe pasi u kthyem vazhduan mësimet Univerzitare, Ana diplomoj në Drejtesi, Angjelina në Pedagogji. Gjergji i këshillonte fëmijet gjithëmonë të pregaditen për tu bërë mësues se është një thirrje profesionale e veçantë, edhe pse mandej fëmijet tjerë i vazhduan studimet në vende tjera, djali Nika diplomoj Fakultetin Ekonomik në Zagreb, Kroaci, i cili sot jeton në New York SHBA, me dy djemtë e tij Georgin dhe Kristoforin, vajza e vogla **Jozefina** diplomoj në Kotorr Shkollën e Lartë Ekonomike, kurse e madhja **Lena** u martu pasi kreu Shkollën e Mesme. Gjergji si intelektual dhe pedagog ishte shumë i aftë dhe kishte njohuri të gjera dhe në lëmitë e përditshme të kohës p.sh. shokët shpesh e veconin në Kosovë, po edhe në vendlindje. Në kohë të lirë, ishte poashtu aktiv në Kosovë merrte pjesë në shoqerinë e gjuetarëve etj. Perspektiva e tij ishte në shumë drejtime, por me tu hapur Shkolla e dytë Fillore në Ulqin, ai ftohet nga nevoja e vendlindjes së tij dhe emrohet Drejtor ne këtë shkollë, pra bëhet Drejtor i parë në Shkollën të cilën Gjergji e emron "Marshall Tito" me lejen e Kabinetit të Titos, kjo shkollë edhe sot funkcionon me të njëjtin emër. Nuk mund të them se ku kishte kenë ma mire te vazhdonim të jetojmë, por Gjergji ka jetuar ashtu ku e ka kerku nevoja e shoqerisë, aty është gjetë, kështu bëri dhe kur shkoj ndër të parët me kolektivin e Shkollës së tij për të vizituar shqiptarë të izoluar nën diktaturen komuniste, edhe atëherë sakrifikoj shumë edhe Postin e tij të Drejtorit, por me këtë rast kundërshtarët e tij deshtuan, humbën me tradhtitë dhe sfidat e tyre, ai mbeti Drejtor deri në Penzion duke i ndihmuar gjithmonë nxënësit e kësaj anë si në pasurimin e njohurive ashtu edhe në vazhdimin e pregaditjeve të mëtejme intelektuale, duke ju siguruar mbështetje edhe në studimet e tyre të mëtejme me Kolegët e tij që kishte edhe jashtë Ulqinit..

Zonja Mrikë, me një rast kam takuar një ish të burgosur Politik nga Istogu me emrin z. Idriz Zeqiraj i cili ishte nxënës i Mësuesit Gjergj dhe ai me tregoj

poashtu se në gjenaratën e tij ka pasur shok të Klases, Presidentin e Kosovës, sot të ndjerin dr.Ibrahim Rugovën, kujtoni dicka nga kjo?

Po, Gjergji i ka patur nxenës, me një rast Gjergji e solli Ibrën në shtëpi i dha ta provoj nje zhaketë të tijen dhe kur i viejti u gëzu shumë dhe ja dhuroj, e afronte shumë Rugoven se ishte nder nxenesit ma te mire te tij. Disa vite më vonë ndegjuam se shoqja më e ngushte e vajzës tonë Angjes në Kosovë, Fana u martua me Ibren. Mirë ma kujtuat, do e pyes Angjen se a ka ende kontakt me Fanën.

Zonja Mrikë ju jetuat dhe u lindët në Brisk, vend në Krajë në Malet e Rumisë, mund të na thoni dicka më afër, e bija e kuj jeni, me cfarë u morët deri sa ishit vajzë?

Jam e bija e Mark Nikës Pjetrit prej Briskut Naltë, stermesa e Pjetrit Nikës i cili kur u kthy prej Stamollet solli dy mushka me florij, bleu shumë toka e shumë kullosa, kullosën ma te madhen e bleu nën Kishë e Briskut. Aty pas luftës te `45 na vunë detyrim të ruajmë dhitë e Partizanëve, unë isha me axhën tem cobaneshë, me një rast mu më iken disa dhi dhe dolem ti kerkojmë me axhën duke i kerkuar i gjetëm 15 prej dhive të cilat ishim futur në Kishë të Briskut. “Si u dukte kisha në atë kohë?” nje rrenoj e cila ende qëndronte në kembë, kishte një pullaz të rronuar dhe gur shume te mdhej si shkama, por te gdhendur ne katrore per tu strukur ashtu si ishin mshehur dhitë tona dhe nuk u shihëshin nga drita që bënte hana. Axha më tha ,a e sheh këtë Kishë, është Kisha e Shën-Mitrit, Festë të cilen e lutshim na Brisku me miq ndersa Ana nga Mikuliqi lutëte Festën e Shën-Markut poashtu ne këtë kishë. Nga Brisku shkonim në Ljare në Kishë. Një ditë prej të dijelave më njohtuan se ka një djalë, është Mësues, kështu nga një vajzë briskanjore fillova një jetë bashkë me Mësues Gjergjin, nga Kllezna e Ana e Malit në Kosovë dhe nga Kosova në Ulqin, ku ende jetoj edhe sot.Gjergji i lindur ne vitin 1921 u nda nga kjo jetë në vitin 1993, por ai vazhdon të jetoj ende në kujtesën time, të fëmijve të tij, nipave dhe mesave, farefisit dhe tërë shokëve dhe vendasëve të tij.

Zonja Mrikë, jemi ende në 100 Vjetorin Jubilar të Kombit shqiptar,cila do të ishte porosia e juaj?

Kjosh me jetë o bir, por për këte kishte ditë më mirë se unë me tu përgjegj Gjergji.

Unë vetëm po thamë, urime,e për shumë mot këto Festa!

Në hap me Rugovën

Në libër ka rrëfime autentike, ilustrime të Rugovizmit, stenograme nga takime të rëndësishme, fotografi ekskluzive, si dhe dokumente të rëndësishme.



Në organizim të Qendrës Kulturore Ulqin, të enjten më 8.11.2012, në mjediset e Bibliotekës së Qytetit u bë përurimi i librit “Në hap me Rugovën” të autorit Adnan Merovci.

Në fillim të përurimit u shfaq filmi dokumentar me titull “Një dekadë me Rugovën 1989-1999”, ndërsa më pas moderatori i mbrëmjes, dr. Nail Draga, zhvilloi një bashkëbisedim me autorin e librit, duke u fokusuar në çështjet e trajtuara në libër.

Para një auditori të përzgjedhur, autori i librit ka elaboruar në detaje çështje të ndryshme, të cilat kanë qenë pothuajse të panjohura për opinionin e gjerë. Ai ishte konkret dhe i qartë në lidhje me çështjet përkatëse dhe sfidat që ka përjetuar gjatë dhjetë viteve sa e ka shoqëruar Presidentin historik të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova.



8.11.2012

Në këtë botim ka rrëfime autentike, ilustrime të Rugovizmit, stenograme nga takime të rëndësishme, fotografi ekskluzive, si dhe dokumente të rëndësishme.

Pasi që përurimi u mbajt në muajin e vitit jubilar të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, në fund nxënësja Flutur Mustafa lexoi tregimin “Rrëfimi i një biri”, që u prit me admirim nga të pranishmit.



8.11.2012

Libri “Në hap me Rugovën” është botuar nga “Amerkos” në Prishtinë, ndërsa deri më tash është përuruar në disa qytete në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe diasporë.

Ismet Kallaba

Studim i guximshëm dhe me vlerë

Shkruan **Ali Gjeçbritaj**




foto: ARB
21.9.2012

Libri,"**Kultura shqiptare në tekstet mësimore të shkollës fillore në gjuhën shqipe në Mal të Zi"- të autorit MA Flamur Anamali,** ndahet në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë autori shtron metodologjinë e hulumtimit, në të dytin bën fjalë për historikun e arsimit në Mal të Zi me theks të veçantë për përmbajtjet mësimore dhe tekstet mësimore; në përmbajtjen e teksteve mësimore të lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi, në të Natyrës dhe Shoqërisë, të Historisë dhe të Kulturës muzikore evidenton mangësi të mëdha. Tekstet e përkthyera janë me shumë gabime përmbajtësore. Historia kombëtare shqiptare mësohet fare pak.

Një fjalë popullore thotë “gjuha ruhet atje ku shkruhet”, pra me shkollimit në gjuhën amtare në çdo nivel, ruhet kultura dhe tarshigimia kulturore e nacionale e një kombi.


foto: ARB
21.9.2012


Konsideroj se mësimdhënësit prindërit e nxënësve, organet profesionale në shkolla, duke u nisur nga Këshillat e klasave, Aktivet profesionale, Këshillat e arsimtarëve të shkollave shqipe, pse jo edhe institucionet më të larta arsimore, duhet të ndërmarrin aktivitete dhe hapa konkret nga se tekstet mësimore, gjegjësisht përmbajtjet në to, që autori shtjellon e analizon në këtë libër, bien ndesh me ruajtjen e identitetit tonë kulturor e kombëtar.

Në fund, letra e bardhe dhe lapsi pranë sajë për shumë kend janë të frikshme. Fjalët i merr era. Çdo gjë që shkruhet mbetet. Flamuri pati guxim. Atë çka foli, ku pati qasje si student, mësimdhënës, studiues e hodhi në letër dhe e dëshmoi se nuk ka frikë nga e vërteta.

Nga fjala e mbajtur me rastin e përurimit të librit në Ulqin, në Shtëpinë e kulturës, më 21.09. 2012.

“*Pishtarët e lirise*” e Gjylaver Avdiut

Shkruan **Ali Gjeçbritaj***



Libri i **Gjylaver Avdiut** “Pishtarët e lirisë” doli nga shtypi më 2012. Në këtë libër autori bën përpjekje për të pasqyruar e gjetur arsyet, shkaqet dhe faktorët që ndikuan në kohëra të caktuara, që shqiptarët të përndiqeshin, të burgoseshin dhe të dënoheshin me burgje hasen vuajtjet, vështirësitë dhe fatkeqësitë që njërëzëve u shkaktoi rruga e lirisë që predikonin.


foto: Pro Studio
18.11.2012

Libri u promovua në Dacaj (Rozhajë), ku folen per librin Avdyl Lajçi dhe Naim Prelvukaj, pastaj në Tuz (folën Adem Demaçi, Dr.prof.Martin Berishaj dhe Dr.Bahnri Brisku), Guci (folen profesor Fadil Ulaj, Selatin Novosella dhe Esat Gjonbalaj nga Njujorku), në Ostros (folën Ali Gjecbritaj dhe Selatin Novosella) dhe Katerkollë (folen Fadil Salaj dhe Selatin Novosella). Promovimi u organizua edhe në SHBA (Detroid, Çikago dhe Njujork).

Mund të thuhet lirisht që ky libër ka një vlerë dokumentuese të rëndësishme.

**Marrë nga* fjala promovuese në Ostros, më 18.11.2012.


18.11.2012
foto: Pro Studio

Kënon Bjega

Bukur Bjega qi po knon
Gjith ushtrija ma nigion,
Kush âsht trim, kush âsht djal
Për me zanun Bjegën gjallë.
Gjon Preçeta trim e djal,
Del e zên-o Bjegen gjallë,
Kapë për flokësh, e hjekë rrëshqanë.
“Mos me hjek, o burr'i keq!
Se nuk jam-o bi e shkretë,
Por ni vlla e kam dhe vetë!”
“Po ku e ke , mos e paç?”
“Mos ma nêmë, goja tu thaftë
Se morra malin edhe treta
E vllanë tem kurrkun s'gjeta!”
“Po, a thua je ti e zeza motër?!
Se unë jam Gjoni, yt vlla!”
Janë zanë grykë si motër e vlla!
Dekun në tokë të dy kanë ra.
Ku ra Gjoni – bini ftoni,
Ku ra Bjega – bini shega.
Këndoi: Marash Gjeloshi, Selishtë, Grudë, Malësia e Mbishkodrës.
Shenoi: Prenkë Gjon Doka
E botoi **ZANI I RINIS,** viti II, nr 7-8, prll-maj 1954:18.
Shih **Kënon blega** *me përmbajtje të ngjashme në* BUZUKU 10/2002:2; BUZUKU 14/2004:21; BUZUKU 32/2010:21.



Shestanesha, Studio Marubbi, 1897, Shkodër - Krajë Albania

Mori e mirë çi ma shtron shtratin

Mori e mirë, çi ma shtron shtratin
A t'ra n'mend për mua të ngratin.
Mua të ngratin – o mua të mjerin,
Natë e ditë po ta ruaj qilerin.
Tue ta ruajt qilerin ty,
Tue ra borë e tue ra shi,
N'dorë manxerrja m'u ka kri.
Çelma derën n'kjofsh turki,
Ni sahat ta bâj me ty,
O, se qita dhetë her allti.
- Pse me qit allti, bre djalë,
Për pa t'thirrë çika me ardhë?
A e din lulë, çi jâm beqar?
Rash n'shtrat, gjumi s'm'ka marr',
Kapa pushken, n'derë t'kam ardhë.
Ta dhash besën, s'kthehem gjallë,
S'kthehem gjallë me shkua n'shpi,
Për pa e bâ kët natë me ty,
Për pa e bâ natën krejt,
Edhe n'm'vrafshin s'po kam dert,
Ta lâ alltin me shtatë fishek,
Ta lâ sahatin me qystekë,
Ta lâ manxerren me gjithë rreth,
E n'kjofsh e zoja, lufton vetë,
N'kjofsh e zoja me luftua,
Neron veten e m'paguan mua,
T'thrrasin burrë, nuk t'thrrasin grua.
Këndoi një grup vajzash i vllëzarisë Hasangjekaj
të fshatit Martinaj në bjeshkën “Qafa e Visitorit”
në korrik të vitit 1977.
Shënoi**: Shaban Hasangjekaj**, Martinaj, Guci

Për ju me miq

Ciceroni në vitin 68 para Krishtit ka shkrue:

1. I vorfni - punon,
2. I pasuni e çfrytzon t'parin,
3. Ushtari - i mpron të dy,
4. Taksapaguesi - i paguen të tre,
5. Endacaku, i pastrehi - pushon për të katërtit,
6. Pijaneci - pin për të pestit,
7. Bankieri - i hajnon të gjashtit,
8. Avokati - i përçan të shtatit,
9. Mjeku - i vret të tetit,
10. Vorrmihsi - i vorros të nantit,
11. Politikani jeton në hesapin e të dhetëve.

Asgja deri sot nuk ka ndryshue.
Zgjodji **Nikë Palkola**, Kllezën, Ulqin, tash n'Njujork, Amerikë.

Agron Ujkashi - ***Halla Gjyle***



Prralla gjonj's

Pata nji pushkë t'keqe,
Pa çark pa kondak,
pa namli, haram aspak
shkova me gjue
te tri kodra
dy t'thame, nji pa barë
ishin tre lisa
dy t'thyem, nji pa rranxë
ranë tre turtuj,
i gjova tam-tërt
dy iken, njani s'met,
mora atë qi s'met,
hajtë-hajtë, te tri kulla
dy t'zhblueme, nji pa tjergulla
thirra: o i zoti shpisë,
dolën tri plaka,
dy t'dekuna, nji pa frymë,
u lypa tre veksha,
m'dhanë dy t'thyem, nji pa fun
mora vekshin pa fun
shtiva turtullin qi s'met,
ziej, përziej,
mora me shprazë
lagu dol, mish nuk met
kurr thatë, veç at'herë
&
Jeta e njeriut (mosha)
Kanë thanë përpara, me'j gjetë:
20 t'marrë, 30 trima
40 burra, 50 mentar
60 kuval, 70 qorra
80 pula, 90 voe.
Halili Muratit Mehmet Ali Haxhisë – Braconj, Pinç, tash në Braticë, Ulqin më 1.11.2012

Filip Shiroka
(1859-1935)

SHQIPNISË, KUSHTRIM, KUSHTRIM!



O dheu im kur i mbrapshti fat të ka ndiekë
Çveshe shpatën e del në luftë;
Uluron rrëfeja, qielli errësohet,
Të fuqishmit e tokës
Përbetue janë për damin tand,
Dheu yt asht i kërcënuem
I poshtnuem asht nderi yt.

Burrneshë e bukur dhe e prujtun
Dikur e lirë dhe kryenaltë,
Të gjithë popujt tue u dridhë
E nderofshin flamurin tand,
Në çdo faqe të historisë
U kujtonte zulmi yt
U kremtonte trinia yte.

Tash nji mbledhje e fshehtë
Të fortin, e pamatur dhe e pabesë,
Mbledhë në salla mbretnore
Ka vendosë fatet e tua
Për rrënim i ka të gatshme mjetet,
Pjellën tande, rrobat tueja,
Copa copa i pat pjestue!

Nuk ndijove?.. në kufij
Kanë me u dukë ani lufte e bomba
Për me i shpërnda çetat tua
Me 'i fuqi ma se mizore;
Të skotës sllave kaq t'urryeme
Donë me të ba robe e skllave.
Nji Kongres e pat njëmend caktua.

Çoju, pra! Kur bje rreziku
Larg vonesa, larg pritesa;
Qoftë për ty këshilltar guximi
Në ketë çast kaq të naltë;
Me guxim flam'rin tand shtjello,
Gjithkund tingulli burive
Ban që të kumbojë!...

Në kambë, Arbënorë, të fortë e trima,
T'ju bashkojë nji kusht i vetëm;
Pasiguria e ditës së nesërme,
Dhimba për tokën Amë:
Qoftë i lig kush nuk rrokë shpatën,
"Luftë e shejtë! Luftë e shejtë!"
Le të shpallet prei Elterve!...

Të falem, Shqipni guximtare e luftare,
E vështirë asht prova;
Por ma shumë se stuhia
I bijve tuej asht guximi;
Ndër malet tueja me armët pranë
Ruej të paprekur, të pandame,
Lirinë e trollit tand!...

Por, nëse për rrisk të pashmangshëm
Ka me të detyrue nji robni të re.
Kongresit të Berlinit
T'i bijë turpi!.. guximin tand
Anmikut tand ia ke diftue,
Tashma e ke në dorë të drejtën e lashtë
Për nji kohë që ka me ardhë.

Po, koha e pritun erdhi, por... mjerisht! Të mbëdhajt e botës, Shqypninë e coptuën, tue i dhanë disa vende t'ona Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë! Mbretënit e Europës së gjytetënueme, qi në mësonjtoret e nalta të tyne mësojnë me hollësi të madhe të Drejtat e njerëzisë (Giusprudenza) e bajmë Ligjë e Nome të shëndoshta për gjykatoret e botës, shofin me udhë me shkelë e me hupë nji komb të vogël qi nuk ka me se me u dalë zot të drejtave t'veta!... Përkthyesi AUKTORI

***

Filip Shiroka këtë vjershë e shkroi më 20 shtator 1880 dhe e botoi po atë vit në gazetën "L'Oservatore Cattolico" të Milanos. Më 1881 vjersha ribotohet në librin e Leonardo de Martinos, "L'arpa d'un italo-albaneze". Autori e botoi në "Lexuesit", hyrjen e librit të tij, "Zani i zemrës", "Nikaj", Shkodër, 1933. Vjersha nuk u përkthye dhe nuk u ribotua asnjëherë pas Luftës II Botërore.

LEXUESIT* *Përpara se me nisë me shkrue në gjuhë Shqype, une shkruejsha në gjuhën italishte, se – pse gjuha e jonë at-herë ishte gjysë për gjysë me fjalë turqishte, greqishte, italishte e sllavishte, e as nji shqyptar, sidomos nga Gegënija nuk guxote me u orvatë me dlirë e me qirue gjuhën e vet, se Turkija nuk nepte leje me mësue shqyptarët veç gjuhët e hueja!..*

Për me i çfaqë botës së qytetnueme t'Europës, mjerimet e pa-udhësitë qi vuente Shqypnija e shkretë nga Mbretnija e Stambollës, qi verbënisht ndigjonte fjalët e anmiqve t'onë (e anmiqve të vet), une, djal i ri atëherë, dërgojsha lajme, javë për javë, nga Shkodra, fletës së madhe "L' Osservatore Triestino", *e fletës* "IL Piccolo" *di Trieste. E ma vonë kur Avulloret luftare të botës së gjytetnueme u nisën me ardhë, më 1878**, nër ujna të Ulqinit, për me shtërngue – kontra të drejtave të njerzisë – ushtarët t'onë, qi ishin lidhë me vdekë, për mos me i a lëshue Ulqinin Malit të Zi, unë botova në Fletoren e vlertë* "L'Osservatore Cattolico" *di Milano, ket vjershë:*

** Është pjesë nga Fjala e autorit drejtuar lexuesve. ** Duhet të jetë një pasaktësi, ngase ngjarjet kanë ndodhur më 1880.*

....

E përktheu nga origjinali, italishtja, në të folmen e Shkodrës:* **Wily KAMSI.

Prof. Wily Kamsi ishte ambasador i jashtëzakonshëm e fuqiplotë i Shqipnisë pranë Selisë së Shenjtë. Kërkoj ndjesë nga përkthyesi i nderuar dhe lexuesit e çmuar që nuk qeshë në gjendje t'i shënoj thekset.

E përgatiti **Hajro ULQINAKU**

Josip Vladović Relja

(1895-1966; Arbanasi, Zadar, Kroacia)

Nana birit në prehën

Edhe në prehën po më fle
Punë të mdhaja don me dijtë!
Për të drejtë, trimní po më pëvet,
Pa njerzí ti s'don m'u rritë?...
I vogël edhe m'je,
Tetë të pllota edhe s'ke...
Me fillue ti po do?
Çeli veshët dhe ndigo:
Me dashtni gjith punët puno,
Kush nuk muje, ati ndihmo!
Gjith puntorve fale nderjen,
Vetë të madhit hape mnerjen!
Gjithkujt nise fjalën të lirë,
B? sa mundesh gjithkujt t'mirë.
Të huajt ruje, të vehtët mbroje,
Të vërtetën gjithmonë doje.
Për të drejtën mos lut njerin!
Kurkuj, biro, mos ulë krenin
Kurkuj, biro, mos bên keq!
Mbau, ndigou me të pleq.
Por, moj biro, me të dashtë ndokush
Faqen, emnin me baltë me mbushë-
Për tambël t'nanës, dhe dashtní
Të motrës. t'vajzes, për dhé, lirí:
Çou në kamb'e mos fle'
Por bje, shtyp, vra e the
Si ërrfe!
Mos len sjapit të nemikut
Nji hap, nji pllamb, as gjys dekikut,
Por – bje
Me dorë, me kambë,
Me uj e zjarm,
Me dhamb,
Me çish ke- bje!
Le të dijnë, le të pajnë, dhe le të mësojnë
Si njerzín, lirín, shoqnín
Arbëreshët e mbrojnë!
Banu i fort si mur,
I fort si gur,
Banu - burr!
Kështu, biro, të mson nana,
Kështu, biro, të don nana.

Marrë nga **ZANI I RINIS,** viti III, nr 3, fruer 1955:4.

Nji komb qi përbuzë traditat e veta vendosë vetëvrasjen e vet (Ernest Koliqi).

* * *

Shërbimin që bën arsimi për përmirësimin e një kombi, ligji s'mund ta bëj kurrë (Sami Frashri).

Në Salç (Ulqin), më 3.2.2001, ishin këto familje:
1.Gjergji Pals Kol' P?l Filipit-Peponj me djalin Pjetrin (2 vetë).
2.Leka'j Gjergjit Leks Pal' Gjoks-Dedonj me të shoqen (2 vetë).
3.Pala'j Lekës Pjetrit Ujkës-Lukiqas, me të shoqen, sipër Kishës Sojmirs (2 vetë).
4.Pala'j Gjurs Pers-Dedonj, në Bardhonj (1).
5.Marku'j Preçit Niks Marluks-Bardhonj (1).
6.Pjetri Niks Pjetrit Kocit-Nilonj (3 vetë).
7.Pala'j Pjetrit Gjurs-Bardhonj me të shoqen (2 vetë).
8.Shoqja Luks Zefit-Bardhonj (1).
Gjithsej 14 banorë
Shënimet i dha: Gjergji Pals Kol' P?l Filipit-Pepaj, më 3.2.2001.

Salçi më 1965 kishte banorë 230 (*Shih* Salçi dikur dhe sot, BUZUKU 28/2008:12.)

Salçi, më 12.10.2012
Lezja (e njoftun me nofkën *Biliqi*, e lindun më 3.3.1927), e bija e Macit Vuks-Dedonj, prej Krythës, e shoqja Markut Preçit Niks Mar'Luks-Bardhonj, jeton në Bardhonj (Salç); për te kujdeset Nika'j Pjetrit Macit Niks Marluks-Martinaj (me rranxë prej Pinçit)- 4 vetë

Ndërroi jetë profesor Gëzim My. Uruçi



Kryetari i speleologëve të Shqipërisë, euroetnologu profesor Gëzim My. Uruçi, prej Shkodre, në spitalin e Tiranës, ndërroi jetë më 17 dhjetor 2012. Të parët e tij ishin me prejardhje prej Ulqinit. Si speleolog, Gëzimi vizitoi 3200 shpella në Shqipëri dhe nëpër Botë; është bartës i titullit honoris causa. Më 1994, Unioni internacional e nderoi me titullin PROFESOR. I ndjeri Gëzim Uruçi ishte bartës i medales së speleologëve të Bulgarisë, si dhe i çmimit "Jurij Gagarin". Ai vinte në Ulqin shpesh, çka ishte kënaqësi e madhe për të. Për këtë humbje të madhe, redaksia e revistës BUZUKU e ngushëllon familjen e të ndjerit.

Nëse ne sot nuk shpallim para gjithë botës përpjekjen tonë për liri, drejtësi e dinjitet kombëtar, atëherë t'i heqim nga sheshet e qyteteve tona statujat e Skënderbeut, ta ulim flamurin e tij dhe le t'ia harrojmë emrin! Ne e meritojmë Skënderbeun si hero kombëtar nëse krijojmë një rilindje të re, nëse punojmë për rimëkëmbjen kombëtare! Koha nuk punon për ne, nëse nuk punojmë ne.. (Enis Starova: JEMI NJË, Shenja (Shkup) 8, dhjetor 2011:8).

Urime e përgëzime – Plavë e Guci

Tu gzoftë zemra.
Tu shtoftë hisja.
Të ruajt Zoti.
Të pastë nâna.
Mos të patë syni i keq.
U baft ni katun pej teje.
Ta dhasht Zoti të marën.
Mos të gjetë gja e ligë.
U rritsh me babë e nânë.
Kudo shkofsh u gëzofsh.
Kjoft shêjti me ty.
T'i marrsha të ligat.
Kjofsh faqebardhë.
Zoti ta pritë të keqen.
Të shkoftë puna marë.
Mos të provoftë Zoti.
T'i ruajt Zoti mënt e kresë.
Hallall t'kjoftë gjini i nânës.
Meleqët kjofshin me ty.
E çoftë Zoti në Xhenet.
Shënoi **Shaban Hasangjekaj**, Martinaj, Guci

Çka po thotë Zefi Kol-Luks,
Një-kta janë ethet e buks.

* * *

Tharku'j thive thuret me thupra thanet.
Thiu theret thellë me thikë t'thatë.
Tregoi Zefi Pals Macit Niks Gjekos Simonit Preçit Gjeçit Kol'Simonit, Braticë, Ulqin.

* * *

Kush dëshiron të bëj diç – gjen mënyrën, kush nuk dëshiron – gjen arsye (Pikaso).

Ndihmuan shoqatën DON GJONN BUZUKU, në Ulqin

Prenç Junku, Boston, SHBA, amerikan $100
Nikollë Dugagjini, €50
Pjeter Marnikoviqi€50
Andri Pekiqi, €50
Jozo Jankoviqi (Krytha e Ulqinit) €100
Shoqata Katolike e Melburnit, australian $500
Shoqata Buzuku nga New York, Zef Gjoka me shoqni dhe simpatizer, amerikan $700
Fondi për pakica i Malit të Zi pjesërisht donator për numrat e Buzukut 37 dhe 38 €1500
Komuna e Ulqinit, €200
Pashko Berisha prej New York, me shoqëri në kontiunitet posaçërisht jemi mirënjohes për ndihmen që i bëri përkrahjes së aktiviteteve të shoqates Buzuku, prandaj ne të gjith jemi mirënjohes .
Shoqatën DON GJONN BUZUKU, në Ulqin të gjithë juveve u falënderohet dhe është mirënjohëse për kontributin tuaj
***

Ndihmuan revistën BUZUKU 38
(Renditja si mbas abecedës)
Antoni Jakut Gjek's Kol-Jakut, Braticë, Ulqin, tash n'Brisbane, Australi-€10.
Antoni Kol's Lucit Noj's-Kovaçi, Kodrat,Ulqin, tash n'Melburn,Australi-$50.
Prof. Dr Bahri Brisku, Mhalla Re, Ulqin-€50.
Giosafatte Capparelli, Via Roma 90, 87010 Acquaformosa CS, Italia-€50.
Ibrahim Milla, MILLA IMPEX, Ulqin-€50.
Irena bija e Verës Milivojës Nedeljko-Cvetkoviqit dhe e Antit Jakut Zefit Markut Nrekës-Pekonj, prej Bishtit Malit, Ulqin, tash në Çikago, Amerikë-nderoi kryeredaktorin.
Lekë Nrekë Marku-Koçaj, Kllezën, Ulqin, tash n'Melburn, Australi-$50.
Nikolla'j Matisë Kols Matisë-Dukagjini, Pistullë, "SOLARIS", Ulqin-€50.
Nikollë Tomë Geg-Gjoni, Kllezën, Ulqin tash n'Melburn, Australi-$50.
Preçi Sim's Jakut Simonit Nik's-Junku, Gaç, Ulqin, tash në Dorchester, MA, USA-€100.
Dr Reshid Rasim Llolla, Kodrat, Ulqin-€30.
Rroku'j Kol's Nik's-Markolonj, Ljarnjan, tash n'Bronx, New York, USA-$100.
Ju po e mundësoni botimin e revistës BUZUKU. Redaksia u falet nderit. Qofshi gjithmonë faqe bardhë.



Foto ARB 27.11.2012

Për shumot Kshnellat dhe Senja e Re 2013

Tel&Fax: 030 411-929
030 401-032
www.milla-impex.com
E-mail: milla-impex@cg.yu
KUALITET DHE CILËSI



